



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI I POLICISË KRIMINALE

Nr. 30P/2 Prot.

Kopje Nr 2
Tiranë, më 08.02.2023.

L ë n d a: Dërgohet urdhëri i ekzekutimit të vendimit të gjykatës.

QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark"

TIRANË

Bashkëlidhur shkresës ju dërgojmë, për njohje dhe ekzekutim Vendimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, Nr.8 Vendimi datë 03.02.2023, për sekuestrimin e shoqërive dhe kuotave të shoqërisë të përshkruar në vendimin e gjykatës.

Materialet e bashkëlidhur janë:

1. Kopje Vendimi të GJ.K.K.O-së, Nr.8 Vendimi, datë 03.02.2023.
1(një) Kopje në 17(shtatëmbëdhjetë) fletë.

Mbyllet me numër rendor 1(një) dhe numër fletësh 17(shtatëmbëdhjetë).

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin ,

DREJTORI
Drejtues i Lartë **Neritan NALLBATI**
Në Mungesë dhe me Urdhër
Drejtues i Parë **Edmond RIZAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE
KRIMIN E ORGANIZUAR

Nr. Regj. Them. 20
Dt. Regj. 30.01.2023

Nr. Vendimi 8
Dt. 03.02.2023

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga :

GJYQTAR - ERJON ÇELA

Sot më datë 03.02.2023, ora 08:00 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi¹, pa praninë e palëve dhe të sekretarisë gjyqësore, çështjen penale me Nr. 20 Regj. Them. me palë :

KËRKUES : Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e përfaqësuar sipas kërkesës nga prokurori Vladimir Mara.

OBJEKTI : Sekuestrim i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në zotërim të shtetasit Ramazan Keskin, i datëlindjes 01.01.1979, lindur në Turqi dhe banues në Shqipëri.

BAZA LIGJORE : Ligji Nr. 10192 dt. 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

Gjykata, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi (sipas parashikimeve të nenit 12/1 të ligjit nr. 10192 dt. 03.12.2009, i ndryshuar) kërkesën e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, shqyrtoi e vlerësoi në tërësi aktet dhe provat bashkëlidhur kërkesës,

¹ Neni 112 pika 4 i K.Pr.Penale me titull “Format e disponimit të gjykatës” përcakton : “... 4.Vendimi merret në dhomën e këshillimit, pa praninë e sekretarit dhe të palëve. ...”.

V Ë R E N :

Se Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në dt. 30.01.2023 ka sjellë për gjykim para Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar kërkesën penale me objekt : *“Sekuestrim i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në zotërim të shtetasit Ramazan Keskin, i datëlindjes 01.01.1979, lindur në Turqi dhe banues në Shqipëri”*.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në zbatim të nenit 12/1 të Ligjit Nr. 10192 dt. 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”* i ndryshuar² procedoj me shqyrtimin e kërkesës në dhomë këshillimi brenda afatit 5 ditor nga data e paraqitjes së saj.

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë së kërkesës së kërkuesit, gjykata mori në shqyrtim kryesisht faktin nëse ka apo jo juridiksion gjyqësor penal dhe nëse është kompetente nga pikëpamja tokësore dhe lëndore për shqyrtimin e kësaj kërkesë.

Juridiksioni gjyqësor penal përcaktohet në nenin 69 të K.Pr.Penale. Kjo dispozitë përcakton se : *“Juridiksioni penal ushtrohet nga gjykatat penale sipas rregullave të caktuara në këtë Kod”*. Bazuar në këtë dispozitë procedurale si dhe duke pasur parasysh ndarjen e juridiksionit gjyqësor, në atë civil dhe penal, Gjykata vlerëson se ka juridiksion për shqyrtimin e kërkesës penale objekt gjykimi.

Po kështu, kjo çështje është në kompetencën lëndore dhe tokësore të kësaj gjykate pasi neni 7 pika 1 i Ligjit Nr. 10192 dt. 03.12.2009, i ndryshuar, përcakton se : *“1. Kërkesa për marrjen e masave parandaluese, sipas këtij ligji, shqyrtohet në shkallë të parë, nga gjykatat e rretheve gjyqësore ose gjykata e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në bazë të kompetencës përkatëse lëndore për veprën penale të kryer, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale”*. Referuar akteve procedurale dhe provave që i janë bashkëlidhur kërkesës rezultoi se shtetasi Ramazan Keskin është i dyshuar për kryerjen e veprave penale *“Trafikimi i narkotikëve”* e kryer në bashkëpunim të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal, *“Grup i strukturuar kriminal”* dhe *“Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”*, të parashikuara nga nenet 283/a – 28/4, 333/a dhe 287 të Kodit Penal, vepra penale të cilat janë në kompetencën lëndore dhe tokësore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (sipas përcaktimeve të nenit 75/a shkronja “b” të K.Pr.Penale³).

² Neni 12/1 i Ligjit Nr. 10192 dt. 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”* i ndryshuar përcakton : *“1. Kërkesa për sekuestrimin e pasurisë shqyrtohet nga gjykata në dhomë e këshillimit brenda pesë ditëve nga data e paraqitjes, në bazë të dokumenteve dhe akteve të paraqitura nga prokurori, ...”*.

³ Neni 75/a shkronja “b” i K.Pr.Penale përcakton : *“Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon: b) çdo veprë penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal; ...”*.

Përcaktimi i kompetencës lëndore është një parakusht procedural shumë i rëndësishëm. Gjykata Kushtetuese lidhur me nocionin “gjykatë e caktuar me ligj” është shprehur se fraza “gjykatë ... e caktuar me ligj” në nenin 42/2 të Kushtetutës mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështje konkrete”. Gjykata, duke pasur parasysh interpretimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me termin “gjykatë e caktuar me ligj”, në përcaktimin e kompetencës lëndore mban parasysh edhe parashikimin e nenit 7 pika 4 të Ligjit Nr. 10192 dt. 03.12.2009, i ndryshuar, i cili parashikon se : “... 4.Kërkesa për marrjen e masave parandaluese, sipas këtij ligji shqyrtohet në shkallë të parë me një gjyqtar. ...”. Sa mësipër, gjykata e shqyrtoj kërkesën objekt gjykimi (kërkesë për sekuestrimin e pasurisë) me një gjyqtar të vetëm.

I. RRETHANAT E FAKTIT.

Nga shpejgimet e dhëna nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në kërkesën penale objekt shqyrtimi rezulton se : Më datën 15.12.2020 nga shërbimet e policisë gjyqësore në Drejtorinë Hetimore janë referuar materialet e para në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në ngarkim të shtetasit Ramazan Keskin, i datëlindjes 01.01.1979, lindur në Turqi dhe banues në Shqipëri, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Trafikimi i narkotikëve” e kryer në bashkëpunim të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal, “Grup i strukturuar kriminal” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 283/a – 28/4, 333/a dhe 287 të Kodit Penal.

Si indicje ka shërbyer informacioni i dërguar nga autoritetet e policisë gjermane sipas të cilit rezulton se : “- Nisur nga hetimet e deritanishme në Gjermani është arritur të konstatohej që organizata kriminale të paktën që nga viti 2018 ka transportuar rregullisht shuma gjashtëshifrore parash me korrierë në rrugë ajrore nga Gjermania, Belgjika dhe Spanja për në Stamboll/Turqi. Dy korrierë u konstatuan në datën 03.10.2018 në Aeroportin e Frankfurtit në tentativë për të dalë jashtë Gjermanisë me nga 420.000 euro secili. Dy korrierë të tjerë parash u kontrolluan në datën 24.08.2019 dhe më 03.09.2019, secili gjatë hyrjes në Aeroportin e Stambollit me nga 180.000 euro dhe 500.000 euro. Një korrier tjetër parash u arrestua në datën 03.09.2019 në tentativë për të dalë nga Aeroporti i Brukselit me 500.000 euro. Nisur nga informacionet e disponuara dyshohet se paratë vijnë nga trafiku i kokainës dhe heroinës, dhe me to duhej të blihej sërish lëndë narkotike ose ato duhej të investoheshin për pasuri të patundshme në Turqi. Sipas informacioneve që kemi, personi nën hetim Ramazan KESKIN ka qëndruar rregullisht në të kaluarën edhe në Shqipëri. Me sa rezulton, ai duhet të ketë aksione në këto dy firma shqiptare :

- Kompania “Global Leader in Sport” (GLS) Shpk (aktivitete sportive), me adresë : Rruga e “Kavajës”, Tiranë.
- Kompania “REALIZ” Shpk (ndër të tjera nxjerrje dhe eksport mermeri), me adresë Rruga “Tre Dëshmorët”, Tiranë.

Nga llogaria e një partneri gjerman biznesi të shtetasit Ramazan KESKIN i janë transferuar në datën 05.05.2020 gjithsej 60.000 euro kompanisë “Realiz” SHPK, Rruga 3 Dëshmorët, Pall INK,

Tirana, IBAN : AL3820511533003237 CLPRCF, Banka "Kombëtare Tregtare" sh.a. Një transfertë tjetër prej 100.000 eurosh në datën 10.09.2020 nga partneri i biznesit i shtetasit Ramazan KESKIN në llogarinë e Realiz SHPK, IBAN: AL3820511533003237 CLPRCF, Banka "Kombëtare Tregtare" sh.a që me sa rezulton nuk është bërë e mundur të kryhet. Në Gjermani ndaj Ramazan KESKIN-it ka një urdhër për sekuestrim pasurie në vlerë 9,5 milionë euro si dhe është person i shpallur në kërkim ndërkombëtar.

Më datë 22.12.2020 Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, bazuar në nenin 287/1 dhe 315/3 të K.Pr.Penale, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve" e kryer në bashkëpunim të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal, "Grup i strukturuar kriminal" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale", të parashikuara nga nenet 283/a – 28/4, 333/a dhe 287 të Kodit Penal.

Më datë 11.02.2021 Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar bazuar në nenin 304/2 të K.Pr.Penale ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore përkatëse nga oficerët e policisë gjyqësore. Janë përdorur sistemet e administruara nga Policia e Shtetit sipas të cilave shtetasi Ramazan Keskin identifikohet me këto të dhëna : Ramazan KESKIN, i datëlindjes 01.01.1979, lindur në Turqi, mbajtës i dokumentit identifikues, kartë identiteti holandeze Nr.INHRR4682, me datë skadence 15.06.2026. Shtetasi Ramazan Keskin ka 101 hyrje në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet Pikave të Kalimit Kufitar : PKK Aeroporti Rinas, PKK Hani i Hotit, PKK Murriqan dhe PKK Morinë.

Automjetet me të cilat ai ka hyrë në Republikën e Shqipërisë janë automjetet me targa : LR777, AA133NC, LR3333, LR999, AA275SB, T750528, KABR1468, LMBR140, LRS005, AA568PM, LRS55, LR888, LRS666, LRAX546, BAAT867, KELFS121, 8XFP13, LMRK879, 4TJV60, AA001BP.

Hyrja e parë e tij në Republikën e Shqipërisë është më datë 21.07.2012 nëpërmjet Pikës së Kalimit Kufitar, Hani i Hotit si këmbësor. Hyrja e fundit e tij në Republikën e Shqipërisë është më datë 06.10.2020 nëpërmjet Pikës së Kalimit Kufitar Aeroporti Rinas.

Shtetasi Ramazan Keskin ka 95 dalje nga Republika e Shqipërisë nëpërmjet Pikave të Kalimit Kufitar : Aeroporti Rinas, Porti Durrës, Hani i Hotit, Murriqan dhe Morinë. Automjetet me të cilat ai ka dalë nga Republika e Shqipërisë janë : LR777, AA275SB, AA133NC, LR3333, LR999, KABR1468, LMBR140, AA567PM, LRS55, LRAX546, LR888, KELFS121, 8XFP13, AA021LP, 8XFP13, LMRK879, AA911LL. Dalja e parë e tij nga Republika e Shqipërisë është më datë 22.07.2012 nëpërmjet Pikës së Kalimit Kufitar, Aeroporti Rinas. Dalja e fundit e tij nga Republika e Shqipërisë është më datë 09.10.2020 nëpërmjet Pikës së Kalimit Kufitar, Aeroporti Rinas.

Nga qyryja e bërë në sistemin TIMS rezulton se shtetasi Ramazan Keskin ka shumë hyrje-dalje nga dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe më konkretisht :

- Hyrje : Viti 2015 - 12 hyrje; Viti 2016 - 26 hyrje; Viti 2017 - 21 hyrje; Viti 2018 - 16 hyrje; Viti 2019 - 17 hyrje, ku shumica është bërë me automjete me targa të huaja, por ka hyrje edhe me automjete me targa shqiptare.
- Dalje : Viti 2015 - 13 dalje; Viti 2016 - 26 dalje, Viti 2017 - 16 dalje, Viti 2018 - 13 dalje, Viti 2019 - 17 dalje, ku shumica është bërë me automjete me targa të huaja, por ka hyrje edhe me automjete me targa shqiptare.

Personat me të cilët ai ka udhëtuar janë: Shtetësja Juna Luan Harka, e datëlindjes 30.10.1982. Nga verifikimet e bëra rezulton se kjo shtetase është bashkëshortja e shtetasit Ramazan Keskin, me të cilin ka edhe një vajzë të quajtur Beliz Rana KESKIN. Shtetësja Juna Harka është e punësuar pranë shoqërisë "MEDIA UNION" shpk, me NIPT Nr. K31609092T, me datë themelimi 15.12.2000 dhe datë regjistrimi 09.04.2003, me adresë, Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga "Sulejman Delvina", Nd. 25, Hyrja Nr.7, me objekt aktiviteti : *"Botimi, prodhimi dhe shpërndarja e revistave, gazetave, organizimi i të gjitha aktiviteteve kulturore, artistike, kryerja e aktiviteteve të marketingut, konsulencë në fushën ekonomike dhe financiare, operacione industriale, tregtare, financiare, civile, mobiliare apo imobiliare etj. - "*, statusi : Aktiv, vend tjetër i ushtrimit të aktivitetit : Autostrada Tiranë - Durrës, km 8, Vorë. Gjokaj, Godia AUTO-CITY, administrator Eridon Lameborshi, ortak shoqëria "UNION GRUP". Ka qënë e punësuar pranë kësaj shoqërie për periudhën Prill 213 – Shtator 2017, periudhë në të cilën ka përfituar pagën bruto në shumën 1.946.213 lekë.

Nga verifikimi i bërë në sistemin policor DEEPSEE rezulton se shtetësja Juna Luan Harka posedon automjetet e mëposhtëme :

- Automjeti autoveturë, marka AUDI, tipi Q7, targa AA275SB, me shasi Nr. WUAZZZ4L3BD026080, viti i prodhimit 2011.
- Automjeti autoveturë, marka MERCEDES BENZ, tipi GLK350, targa AA275BI, me shasi Nr. WDC2049831F573138, viti i prodhimit 2011.
- Posedon pasurinë e paluajtshme Nr. 157/13, ZK. 3292, Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-100-(26-B), me adresë, Selitë, Tiranë, me sipërfaqe 1000 m2, e llojit "ullishte", blerë në shumën 15 000 euro.

Shtetasja Juna Harka, është e bija e shtetasve : Luan Zenel HARKA, i datëlindjes 09.01.1951, aktualisht pensionist. Përfiton pension të plotë pleqërie në shumën 22.709 lekë. Zhaneta Islam HARKA, e datëlindjes 01.03.1955. Prej muajit Janar 2012 deri në muajin Janar 2016 ka qënë e punësuar pranë "QENDRA PRITËSE TË TRAFIKUT", Linzë, Tiranë.

Nga verifikimi i bërë në sistemin policor DEEPSEE rezulton se shtetësja Zhaneta Islam Harka posedon automjetin e mëposhtëm : automjeti autoveturë, marka Wolkswagen, tipi Golf, targa TR5144K, me shasi Nr. WWZZZ1HZNB015563.

Shtetasi Eridon Lameborshi, i cili është administrator i shoqërisë "MEDIA UNION" shpk, shoqëri në të cilën shtetësja Juna Harka ka qënë e punësuar në periudhën Prill 2013-Shtator 2017 identifikohet si më poshtë : Eridon Petref LAMEBORSHI, i datëlindjes 22.01.1971. Prej vitit 2008

dhe në vazhdim është i punësuar pranë shoqërive Automobile Touring Club Albania, "KLUBI I AUTOMOBILIT TË SHQIPËRISË ", UNION FINANCIAR TIRANË, MEDIA UNION në të cilën është administrator.

Andis Neli, i cili identifikohet me gjeneralitetet e mëposhtme : Andis NELI, i biri i Nazmi dhe Servete, i datëlindjes 28.07.1979, lindur në Burrel, Mat dhe banues, Njësia bashkiake Nr. 9, Rruga "Jordan Misja", Tiranë, me numër personal Nr. H90728064V. Më datë 21.02.2012 ka bërë ndërrimin e emrit nga "Altn" në "Andis", të cilin e ka aktualisht. Ky shtetas figuron i punësuar dhe në emër të tij derdhen sigurimet shoqërore nga shoqëritë : "REALIZ" shpk- Nr. NIPT L71822022A; "Global Leader in Sport (GLS)" shpk- Nr. NIPT L92229020F; "Andis NELI" Person Fizik- Nr. NIPT L52024010J.

Në shoqërinë "REALIZ" shpk ky shtetas është administrator dhe ortak me pjesëmarrje në përqindje 50%. Vlera e kapitalit, që zotëron shtetasi Andis Neli është në para, në shumën 34.096.500 lekë. Ortak tjetër është shtetasi Ramazan Keskin, ortak me pjesëmarrje në përqindje 50%. Vlera e kapitalit, që zotëron shtetasi Ramazan Keskin është në para, në shumën 34.096.500 lekë.

Në shoqërinë "Global Leader in Sport (GLS)" shpk, ky shtetas është administrator dhe ortak me pjesëmarrje në përqindje 25%. Vlera e kapitalit, që zotëron shtetasi Andis Neli është në para, në shumën 25 000 lekë. Ortakë të tjerë janë:

- 1- Shtetasi italian Massimiliano Suglia, ortak me pjesëmarrje në përqindje 50%.
- 2- Shtetasi Ramazan Keskin, ortak me pjesëmarrje në përqindje 25%. Vlera e kapitalit, që zotëron shtetasi Ramazan Keskin është në para, në shumën 25 000 lekë.

Shtetasi Andis Neli zotëron edhe shoqërinë "Andis NELI" Person Fizik. Të tre shoqëritë janë me status "Aktiv". Nga verifikimi i bërë në sistemin DEEPSEE, që administrohet nga policia e shtetit rezulton se ky shtetas posedon pasuritë e mëposhtme :

- Automjetin autoveturë, marka Mercedes Benz, me targë AB888ZL, me shasi Nr. WDD2221321A057277.
- Automjetin autoveturë, marka Audi, me targë AA908IZ, me shasi Nr. WAUZZZ4E47N010161.
- Automjetin autoveturë, marka Audi, me targë AA133NC, me shasi Nr. WAUZZZ4H1AN002469.

Shtetasi Ramazan Keskin dhe shtetasi Andis Neli kanë të regjistruar në Shqipëri operatorët ekonomikë të mëposhtëm :

- Operatori ekonomik "GLOBAL LEADER IN SPORT (GLS)" shpk - Nr. NIPT L92229020F, regjistruar më datë 29.10.2019, datë themelimi 28.10.2019, me adresë Business Center Sun Toçer, Rruga e "Kavajës, Tiranë, me objekt veprimtarie "*Organizimi i eventeve sportive duke përfshirë: Vendosja ose ngritja e skenave për eventet e futbollit; Rekrutime të personelit në lidhje me ndeshjet që do të zhvillohen kudo; Blerje të veshjeve sportive; Blerja e biletave të avionit; Rezervimi i hoteleve. Shitja e biletave të futbollit etj.*

Shoqëria do të ketë si objekt organizimin e eventeve të futbollit në Shqipëri dhe mbare botën në rang ndërkombetar si : Fitesën për pjesmarrjen e legjendave të futbollit në evente sportive të organizuar nga vetë shoqëria etj.“ Administrator : shtetasi Andis Neli. Ortakë : Shtetasi Andis Neli me 25 % të aksioneve, shtetasi italian Massimiliano Suglia me 50% të aksioneve dhe shtetasi Ramazan Keskin me 25% të aksioneve. Statusi: “Aktiv”. Për vitet 2019 - 2020 ka deklaruar këto të ardhura : Viti 2019 - Humbje në shumën 56 949 lekë; Viti 2020 - Humbje në shumën 401 693 lekë. Pra, në total kjo shoqëri për dy vite të ushtrimit të veprimtarisë ka deklaruar humbje në total në shumën: 458.642 lekë.

- **Operatori Ekonomik “KESKINDAG” shpk** - Nr. NIPT L71726012K, regjistruar më datë 26.05.2017, datë themelimi 24.05.2017, me adresë Njësia Administrative Nr.10, Rruga “Kajo Karafili”, Vila 2-katëshe Nr.18, Tiranë, me objekt veprimtarie “ - Restorant, Bar, Kafe. Shërbime të cateringut. Të hapë restorante, ti manaxhoje ato, ti japë me qira. Tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve industrial, ushqimor, bujqësor, detar, ndërtim etj. Prodhim dhe tregtim me shumicë e pakicë të artikujve tregtar, konfeksione, tekstil për llogari të vet dhe për të tretë. Ndërtim civil, industrial, infrastrukturë. Shit-blerje me pakicë dhe shumicë të çdo artikulli tregtar që mund të tregtohet brenda legjislacionit Shqiptar. Import eksport. Shit-blerje mjetesh motorrike apo makineri të ndryshme për transport personal dhe publik. Marrja pjese nëpër ankande dhe tendera, si dhe të bëjë shërbime që kanë lidhje me objektin e veprimtarisë së saj. Blerje pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, t'i marrë ose t'i lëshojë me qera, të marrë tenderin e tyre. Shoqëria, mund të kryejë për përmbushjen e qëllimeve të saj çdo lloj operacioni tregtar, mund të vendosë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, t'a hipotekojë këtë pasuri në rregjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të saj. Mund të hyjë në tratativa dhe biznese me shoqëri të tjera që kanë të njëjtin objekt veprimtarie për të realizuar fitime në fushat e përmendura në këtë nen. Përfitojë, transferojë, të marrë apo japë me qera, të blejë dhe shesë, si dhe të kontraktoje, të drejtën e markës, patentës, licences, dhe të drejtat e tjera që janë të ngjashme me këto. Shoqëria, siç mund të ushtrijë punët që tregohen në objektin e veprimtarisë së saj, brenda dhe jashtë vëndit, ashtu edhe mund të marrë pjesë, të përfitojë apo të, transferojë nga/të palët e tjera, mund të marrë pjesë në kapitalet e personave juridike dhe fizike, të vëndit apo te huaj, të krijuar ose që krijohen me qëllim tregtie, industrie, etj., në lidhje me këto fusha”. Administratorë: Shtetasit Mustafa Dag dhe Mehmet Dag. Ortakë: Shtetasi Mustafa Dag me 25 % të aksioneve, shtetasi Ramazan Keskin me 50% të aksioneve dhe Mehmet Dag me 25% të aksioneve. Statusi: “Aktiv”. Për vitet 2017 - 2018 ka deklaruar këto të ardhura: Viti 2017 - Humbje në shumën - 172.235 lekë; Viti 2018 - Nuk ka të dhëna për fitim/humbje. Pra, në total kjo shoqëri për dy vite të ushtrimit të veprimtarisë ka deklaruar humbje në total në shumën : 172.235 lekë.
- **Operatori Ekonomik “REALIZ” shpk** - Nr. NIPT L71822022A, regjistruar më datë 22.06.2017, datë themelimi 05.06.2017, me adresë, Rruga “Tre Dëshmorët”, Pallati Ink, Kati I, Yzberish, Kashar, Tiranë, me objekt veprimtarie “ - shfrytëzim të mineraleve të grupit të ndërtimit dhe metalor. Ushtrimi i aktivitetit të shfrytëzimit minerar për mineralin

Traktollit, import - eksport; Shfrytezim i burimeve natyrore të tokës dhe nëntokës të burimeve natyrore, gjeometrike etj. Import eksport i materialeve tekstile, konfeksione, makineri e pajisje qepëse të tekstileve, përpunim, konfeksionim e qepje e tregtim me shumicë e pakicë i konfeksioneve. Transaksione financiare nga Shqipëria për jashtë dhe nga jashtë për në Shqipëri. Të merret me promovimin e shkëmbimeve tregtare nga Shqipëria për jashtë dhe nga jashtë për në Shqipëri. Të merret me tërheqjen e investimeve dhe investitoreve të huaj në Shqipëri. Të merret me ofrimin e shërbimeve këshillimore për investitorët e huaj. Të merret me studimin dhe prezantimin e mundësive të mira për biznes dhe aktivitete investuese në Shqipëri. Të merret me ofrimin e ndihmave teknike dhe ligjore për kompanitë e huaja që duan të merren e investojnë në Shqipëri veçanërisht në fushën e infrastrukturës (konfeksione të të gjitha llojeve, ndërtim, energji, burimet ujore, etj). Hapje agjensi imobiliare. Hapje agjensi punësimi dhe ndërmjetësimi. Hapje agjensi reklamash dhe publicitare. Zgjidhje, shërbime, konsulence, trajnime në fushën e informacionit. Importim dhe eksportim si dhe tregëtim me shumicë dhe pakicë e artikujve të ndryshëm industrial e ushqimor, pjesë këmbimi. Ndërtime civile - industriale- turistike- bujqësore, rikonstruksione. Ndërtim banesë me skelet mbi 8 kate. Ndërtime rrugore. Ndërtim rruge kategoria IV dhe V. Ndërtim rruge kategoria III dhe II. Punime të mirembajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndërtim mbi shtresa rrugore. Ndërtim autostrade, pista, aeroporte, heliporte. Ndërtime hidraulike e Hidroteknike. Ndërtimi ujesjellës - kanalizime- kanale dhe impiante vaditëse. Punime mbrojtje të sistemit hidraulik- cimentime etj. Ndërtim impiante të trajnimit të ujit. Ndërtim vajsjellës, gazsjellës, naftësjellës. Ndërtim diga - damba deri në 10 m. Ndërtim galeri - tunele. Ndërtim diga të larta. Vepra të veçanta e punime specifike, sillose, kulla, kulla uji etj - metalike. Përforcime themeli e punime nën tokësore. Izolime mbi dhe nën tokësore nga ujërat. Themele të veçanta. Puse, shpime gjeologjike inxhinerike - shpime për ujë. Punime restaurimi, restaurimi i ndërtesave monument kulture. Punime restaurimi i veprave arkeologjike. Punime karpentiere. Druri. Metali. Impiante teknologjike dhe të veçanta. Instalimi i impianteve ngritëse dhe transportuese ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues në përgjithësi) - mirëmbajtja e tyre. Instalimi i impianteve termikeventilimit- kondicionimit të ajrit- mirembajtja e tyre. Instalimi i impianteve higjienike, kuzhina, lavanderi, hidrosanitare, mirëmbajtja e tyre. Punime shërbimi. Punime me sipërfaqe të gjelbërta parqe - pyll parqe. Pastrimi i sipërfaqeve urbane. Kryerja e punimeve në shërbesa funerale. Mirembajtja dhe zhvillimi i dekorit në mjedise urbane, ndriçimi e sinjalizimi urban. Ky aktivitet do të ushtrohet pas marrjes së licencës. Importim dhe eksportim si dhe tregëtim me shumicë dhe pakicë e artikujve të ndryshëm industriale e ushqimore, pjesë këmbimi të paisjeve kompjuterike, elektro- shtëpiake. Tregëtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me shumicë dhe me pakicë artikuj të ndryshëm ushqimorë, elektike, kompjuterike, hidrosanitare, hidraulike, prodhime qeramike, konfeksione të ndryshme, prodhime kozmetike dhe estetike të ndryshme, bimë medicinale dhe eterovajore. Tregëtim të lëndës drusore, bojërave të ndryshme plastike për mure e fasada, kimikate e lënde të para për prodhimin e tyre. Hapje

dhe shfrytëzim hotelesh, bare, restorante, diskoteka, qendra pushimi dhe kurative. Punime druri mobilje, orendi prodhime duralumini dhe tregetimi i tyre. Prodhim materiale të ndryshme ndërtimi si pllaka për shtrim e veshje të objekteve të ndërtimit, banesave, tulla e tjegulla të llojeve të ndryshme. Investime dhe pjesëmarrje në investime duke bashkëpunuar me shoqëri të tjera vendase dhe të huaja në fuzhat e industrise, bujqësisë, industrise ushqimore transport si dhe ndërtim të objekteve si të banesave shumëkatëshe, ura, kanalizime, dekore të fasadave e rikonstruksione të godinave të llojeve të ndryshme, etj. Aktivitet në fushën e transportit të brëndshëm e të jashtëm për udhëtare e për mallra në menyre tokësore si dhe servise për të gjitha llojet e automjeteve. Studime, projektme, ndërtme civile hidroteknike dhe hidroenergjitike, prodhim dhe tregëtim të energjise elektrike, ndërtim e shfrytëzim të rrjetit hidroenergjitik, linjë prodhimi ujl të pishëm dhe lëngje të tjera e mirëmbajtje të tyre. Aktivitete në fushën e ndërtimit: Germime dheu me punime eventuale murature e beton armë prishje dhe punime në toke të gërmuar. Prodhim material ndërtimi. Prodhim material inerte- gurë. Prodhime qeramika tulla-tjegulla-fajance. Prodhim elementë betoni e betonarme të zakonshëm pararendur- gurë dekorative. Prodhim materiale lidhës gelqere- allçi çimento. Prodhim materiale me bazë bittumi sintetike. Ndërtme civile dhe ekonomike. Ndërtme civile industrial-turistike- bujqësore. Aktivitet në fushën e restaurimit të Monumenteve Historik dhe ato kulturore – “.

Administratorë : Shtetasi Andis Neli. Ortakë: Shtetasi Ramazan Keskin me 50% të aksioneve dhe Andis Neli me 50% të aksioneve. Statusi: “Aktiv”. Adresa të tjera të zhvillimit të aktivitetit: -Aktivitet minerar me zonë konkurruese Nr.713/2, Fushë-Laje, Pukë, -Aktivitet minerar me zonë konkurruese Nr.970/2, për mineralin gëlqeror i mermerizuar në godinën private 1-katëshe, nr. 1, Fshati "Melove" , Rruga Gjerbes. Ka deklaruar këto të ardhura :

Viti 2017 Fitim në shumën 172 235 lekë

Viti 2018 Humbje në shumën - 307 229 lekë

Viti 2019 Humbje në shumën - 7 364 252 lekë

Viti 2020 Humbje në shumën - 18 573 557 lekë

Pra, në total kjo shoqëri për keto vite të ushtrimit të veprimtarisë ka deklaruar humbje në total në shumën 261 628 803 lekë. Nga analizimi i zërave të bilancit ndër vite vihet re se : në vitin 2017 zërat e bilancit përbëhen vetëm nga aktive dhe detyrime afatshkurtra. Në vitin 2018 konstatohet një rritje e aktiveve materiale nën zërin “Të tjera instalime dhe pajisje në vlerën 9 701 707 lekë. Në vitin 2019 konstatohet një rritje në “Impiante dhe makineri” për shumën 15 578 870 lekë. Në vitin 2020 konstatohet përsëri një rritje në aktivet afatgjata në zërin “Impiante dhe makineri” për shumën 104 792 044 lekë.

Shoqëria “REALIZ” shpk rezulton me humbje tre vitet e fundit dhe kjo humbje është më e madhe nga viti në vit. Ajo që konstatohet nga bilanci është fakti që në tre vitet e fundit shoqëria ka kryer investime në aktive afatgjata në vlera relativisht të larta. Pavarësisht faktit që aktiviteti i shoqërisë ka patur një rritje nga viti në vit, investimet në “Makineri dhe



pajisje” kanë qënë në vlera shumë të larta dhe kjo mund të jetë arsyeja që shoqëria rezulton me humbje në tre vitet e fundit.

- Operatori Ekonomik “ANDIS NELI”, Person Fizik (PF) - Nr. NIPT L52024010J, regjistruar më datë 24.08.20157, me adresë, Bulevardi “Blu”, Pallati AG&AR, Kamëz, Tiranë, me objekt veprimtarie “ - Bar-Kafe – “. Forma ligjore : Person Fizik (PF). Statusi: “Aktiv”. Për vitet 2017-2018 ka deklaruar këto të ardhura : Viti 2015 - Fitim në shumën 43 387 lekë; Viti 2016 - Fitim në shumën 34 066 lekë; Viti 2017 - Fitim në shumën 158 852 lekë, Viti 2018 - Fitim në shumën 427 762 lekë; Viti 2019 - Nuk ka të dhëna për fitim/humbje. Pra, në total kjo shoqëri për pesë vite të ushtrimit të veprimtarisë ka deklaruar fitim në total në shumën: 664 067 lekë.

Shtetasi Andis Neli ka deklaruar këto të ardhura nga punësimi (në monedhën lek) në vite :

Viti	Subjekti	Paga bruto	Totali për periudhën	Të ardhurat bruto mesatare në muaj
2015	Andis Neli	22,000	110,000	9,166.6
2016	Andis Neli	22,000	264,000	22,000
2017	Andis Neli+Realiz	22,000-24,000	430,550	35,879
2018	Realiz	24,000 dhe 125,000	591,000	49,250
2019	Realiz+GLS	125,000-148,879	1,929,077	160,756
2020	Realiz+GLS	26,000 dhe 148,879	2,098,548	174,879
2021	Realiz	150,956	603,824	150,956
Në total shtetasi Andis Neli ka përfituar rrogë bruto për vitet 2015-2021 në shumën 6 026 999 lekë.				

Nga ana e organit të akuzës është kërkuar dhe marrë informacion nga sistemi banker, bankat e nivelit të dytë.

Banka “Raiffeisen” sha. Me shkresën Nr. 4185/1 Prot, datë 25.03.2021 Banka “Raiffeisen”, informon se ka llogari bankare pranë kësaj banke vetëm shtetasi Altin Nazmi Neli alias Andis Nazmi Neli.

- Llogari Nr. 2500832752, në monedhën lek, çelur më datë 22.01.2008. Llogaria është kredituar në shumën 687 673 lekë dhe debituar në shumën 677 203 lekë. Balanca në llogari

më datë 01.01.2021 është 10 469 lekë. Llogaria është kredituar me derdhje cash nga ky shtetas dhe debituar me tërheqje cash dhe tërheqje në ATM dhe komisionet e bankës.

- Llogari Nr. 0003832752, në monedhën euro, çelur më datë 23.03.2012. Llogaria është kredituar në shumën 7978 euro dhe debituar në të njëjtën shumë. Balanca në llogari më datë 01.01.2021 është zero euro. Llogaria është kredituar me një transfertë me përshkrimin "Urdhërues E.Sinomati-" dhe debituar me tërheqje cash nga shtetasi Altin Neli.
- Llogari Nr. 8001832752, në monedhën paund, çelur më date 28.05.2009. Llogaria është kredituar në shumën 35 968 paund dhe debituar në të njëjtën shumë. Balanca në llogari më datë 01.01.2021 është zero paund. Llogaria është kredituar me transfertë me përshkrimin "-Urdhërues E.Sinomati-" dhe "Urdhërues J.Klosi-" debituar me tërheqje cash nga shtetasi Altin Neli.


Banka "Kombëtare Tregtare". Me shkresën Nr. 1105/1 Prot, datë 11.03.2021 Banka "Kombëtare Tregtare", informon se kanë llogari bankare pranë kësaj banke shtetasi Andis Nazmi Neli dhe shoqëria "REALIZ" shpk.

Andis Neli:

- Llogari Nr. 503788956, në monedhën euro, çelur më datë 20.06.2014 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 13.016 euro dhe debituar në shumën 12.716 euro. Balanca në llogari më datë 11.03.2021 është 299 euro. Llogaria është kredituar me derdhje cash nga ky shtetas dhe debituar me një transfertë në shumën 9 000 euro në favor të shtetasit Gjelo Mark Prendi me përshkrimin "-Për blerje automjeti, sipas kontratës noteriale Nr.rep/kol 1982/1279, datë 19.12.2020-", tërheqje cash dhe komisioni i bankës.
- Llogari Nr.503788956, në monedhën lekë, çelur më datë 20.06.2014 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 2 057 650 lekë dhe debituar në të njëjtën shumë. Balanca në llogari më datë 11.03.2021 është zero lekë. Llogaria është kredituar me derdhje cash nga ky shtetas dhe pagën mujore nga shoqëria "REALIZ" shpk. Debituar me tërheqje cash dhe tërheqje në ATM si dhe komisione të bankës.

Shoqëria "REALIZ" shpk:

- Llogari Nr.503003237, në monedhën euro, çelur më datë 06.09.2017 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 504.734 euro dhe debituar në të njëjtën shumë. Balanca në llogari më datë 11.03.2021 është zero euro. Llogaria është kredituar me veprimet si më poshtë :
 - Më datë 19.01.2018 llogaria është kredituar në shumën 1 300 euro me derdhje cash nga shtetasi Andis Neli.
 - Më datë 26.01.2018 llogaria është kredituar në shumën 4 200 euro me transfertë nga Saimir Etemoviç.
 - Më datë 18.04.2018 llogaria është kredituar në shumën 2 200 euro me transfertë nga Saimir Etemoviç.
 - Më datë 03.05.2018 llogaria është kredituar në shumën 1 550 euro me transfertë nga shoqëria "INVEST DOO".



- Më datë 05.09.2018 llogaria është kredituar në shumën 200 000 euro me transfertë nga Ramazan Keskin.
- Më datë 01.04.2019 llogaria është kredituar në shumën 1 069 euro me transfertë nga shoqëria "FERI TRI ABEE".
- Më datë 08.05.2018 llogaria është kredituar në shumën 3 200 euro me transfertë nga AZZOLLINI NICOLA MARMI DI NICOLA.
- Më datë 09.07.2019 llogaria është kredituar në shumën 18 200 euro me transfertë nga shtetasi EMRAH BELLI.
- Më datë 24.07.2019 llogaria është kredituar në shumën 1 500 euro me transfertë nga shoqëria "INVEST DOO".
- Më datë 10.07.2019 llogaria është kredituar në shumën 2 200 euro me derdhje cash nga shtetasi Andis Neli.
- Më datë 11.10.2019 llogaria është kredituar në shumën 3 000 euro me transfertë nga shoqëria "INVEST DOO".
- Më datë 12.11.2019 llogaria është kredituar në shumën 17 313 euro me transfertë nga shoqëria "PROJEKTENTWICKLUN ACTIV BAU UND".
- Më datë 09.01.2020 llogaria është kredituar në shumën 34 802 euro me transfertë nga shoqëria "H+T WOHNBAU GMBH+CO".
- Më datë 30.03.2020 llogaria është kredituar në shumën 14 642 euro me transfertë nga shoqëria "HIBG VERWALTUNGS-GMBH".
- Më datë 30.03.2020 llogaria është kredituar në shumën 19 937 euro me transfertë nga shoqëria "ATASOY GROUP ELEKTRIK ELEKTRONIK".
- Më datë 07.05.2020 llogaria është kredituar në shumën 59 830 euro me transfertë nga shoqëria "HBG VERWALTUNGS-GMBH".
- Më datë 11.06.2020 llogaria është kredituar në shumën 99 730 euro me transfertë nga shoqëria "HBG VERWALTUNGS-GMBH".
- Më datë 17.08.2020 llogaria është kredituar në shumën 4 444 euro me transfertë nga shtetasi Aga Naxhi.
- Më datë 15.12.2020 llogaria është kredituar në shumën 1 000 euro me derdhje cash nga shtetasi Andis Neli.

Llogaria është debituar me veprimet si më poshtë:


- Më datë 19.01.2018 llogaria është debituar në shumën 1 300 euro me përshkrimin "*transfertë për shoqërinë A-LOGISTICS COMPANY shpk"-likuidim faturash-*".
- Më datë 10.09.2018 llogaria është debituar në shumën 2 000 euro me përshkrimin "*tërheqje cash nga Andis Neli-*".
- Më datë 21.09.2018 llogaria është debituar në shumën 1 800 euro me përshkrimin "*tërheqje cash nga Andis Neli-*".
- Më datë 24.09.2018 llogaria është debituar në shumën 2 000 euro me përshkrimin "*tërheqje cash nga Andis Neli-*".

- Më datë 05.11.2018 llogaria është debituar në shumën 2 000 euro me përshkrimin“-
tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 12.11.2018 llogaria është debituar në shumën 1 500 euro me përshkrimin“-
tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 12.11.2018 llogaria është debituar në shumën 3 500 euro me përshkrimin“-
transfertë me këmbim valutor nga euro në lek-“.
- Më datë 15.11.2018 llogaria është debituar në shumën 3 000 euro me përshkrimin“-
transfertë me këmbim valutor nga euro në lek-“.
- Më datë 23.11.2018 llogaria është debituar në shumën 2 850 euro me përshkrimin
“-*transfertë me këmbim valutor nga euro në lek-*“.
- Më datë 03.12.2018 llogaria është debituar në shumën 10 000 euro me përshkrimin
“-*transfertë për shoqërinë "SHAMO-CONSTRUCTION shpk- likuidim fature për
blerje eskavatori-*“.
- Më datë 04.12.2018 llogaria është debituar në shumën 10 000 euro me përshkrimin
“-*transfertë për shoqërinë "SHAMO-CONSTRUCTION shpk- likuidim fature për
blerje eskavatori-*“.
- Më datë 11.12.2018 llogaria është debituar në shumën 5 000 euro me përshkrimin
“-*transfertë me këmbim valutor nga euro në lek-*“.
- Më datë 11.12.2018 llogaria është debituar në shumën 3 500 euro me përshkrimin
“-*transfertë me urdhërues shtetasin Andis Neli dhe përfitues shtetasi Julian
Kastriot Guri me përshkrimin pagesë qera mujore-*“.
- Më datë 14.12.2018 llogaria është debituar në shumën 2 000 euro me përshkrimin
“-*transfertë me këmbim valutor nga euro në lek-*“.
- Më datë 18.12.2018 llogaria është debituar në shumën 8 00 euro me përshkrimin “-
transfertë për pagesë tarife oponencë teknike-“.
- Më datë 27.12.2018 llogaria është debituar në shumën 12 000 euro me përshkrimin
“-*transfertë me këmbim valutor nga euro në lek-*“.
- Më datë 07.01.2019 llogaria është debituar në shumën 14 186 euro me përshkrimin
“-*transfertë në favor të shoqërisë SERAY ULUSLARARASI TASIMACILIK-*“.
- Më datë 10.01.2019 llogaria është debituar në shumën 3 500 euro me përshkrimin
“-*transfertë me urdhërues shtetasin Andis Neli dhe përfitues shtetasi Julian
Kastriot Guri me përshkrimin pagesë qera mujore-*“.
- Më datë 10.01.2019 llogaria është debituar në shumën 3 000 euro me përshkrimin
“-*transfertë me këmbim valutor nga euro në lek-*“.
- Më datë 21.01.2019 llogaria është debituar në shumën 5 000 euro me përshkrimin
“-*transfertë me këmbim valutor nga euro në lek-*“.
- Më datë 28.01.2019 llogaria është debituar në shumën 1 500 euro me përshkrimin
“-*tërheqje cash nga Andis Neli-*“.




- Më datë 11.02.2019 llogaria është debituar në shumën 2 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 11.02.2019 llogaria është debituar në shumën 9 600 euro me përshkrimin “-transfertë në favor të shoqërisë STONE PRODUCTION sh.p.k, për likuidim fature.“
- Më datë 11.02.2019 llogaria është debituar në shumën 23 000 euro me përshkrimin “-transfertë në favor të shoqërisë GENKLAUDIS sh.a, me përshkrimin likuidim fature-“.
- Më datë 11.02.2019 llogaria është debituar në shumën 1 100 euro me transfertë për shoqërinë “FERI TRI”.
- Më datë 11.02.2019 llogaria është debituar në shumën 2 000 euro me përshkrimin “-transfertë me këmbim valutor nga euro në lek-“.
- Më datë 11.02.2019 llogaria është debituar në shumën 3 500 euro me përshkrimin “-transfertë me urdhërues shtetasin Andis Neli dhe përfitues shtetasi Julian Kastriot Guri me përshkrimin pagesë qera mujore-“.
- Më datë 19.02.2019 llogaria është debituar në shumën 3 000 euro me përshkrimin “-transfertë me këmbim valutor nga euro në lekë-“.
- Më datë 22.02.2019 llogaria është debituar në shumën 5 600 euro me përshkrimin “-transfertë për Lester Qalliaj PF –likuidim fature për riparim motorri-“.
- Më datë 22.02.2019 llogaria është debituar në shumën 2 500 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 05.03.2019 llogaria është debituar në shumën 3 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 11.03.2019 llogaria është debituar në shumën 3 500 euro me përshkrimin “-transfertë me urdhërues shtetasin Andis Neli dhe përfitues shtetasi Julian Kastriot Guri me përshkrimin pagesë qera mujore-“.
- Më datë 12.03.2019 llogaria është debituar në shumën 390 euro me përshkrimin “-transfertë HYDROPOËER shpk –likuidim fature -“.
- Më datë 13.03.2019 llogaria është debituar në shumën 8 300 euro me përshkrimin “-transfertë në favor të shoqërisë GENKLAUDIS sh.a, me përshkrimin likuidim fature-“.
- Më datë 19.03.2019 llogaria është debituar në shumën 3 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 20.03.2019 llogaria është debituar në shumën 1 000 euro me përshkrimin “-transfertë me këmbim valutor nga euro në lekë-“.
- Më datë 04.04.2019 llogaria është debituar në shumën 2 100 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 08.04.2019 llogaria është debituar në shumën 1 000 euro me përshkrimin “-transfertë me këmbim valutor nga euro në lekë-“.

- Më datë 10.04.2019 llogaria është debituar në shumën 3 500 euro me përshkrimin “-transferitë me urdhërues shtetasin Andis Neli dhe përfitues shtetasi Julian Kastriot Guri me përshkrimin pagesë qera mujore-“.
- Më datë 10.04.2019 llogaria është debituar në shumën 2 300 euro me përshkrimin “-transferitë me këmbim valutor nga euro në lekë-“.
- Më datë 15.04.2019 llogaria është debituar në shumën 5 000 euro me përshkrimin “-transferitë me këmbim valutor nga euro në lekë-“.
- Më datë 17.04.2019 llogaria është debituar në shumën 3 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 23.04.2019 llogaria është debituar në shumën 1 000 euro me përshkrimin “-transferitë me këmbim valutor nga euro në lekë-“.
- Më datë 30.04.2019 llogaria është debituar në shumën 3 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 08.05.2019 llogaria është debituar në shumën 3 500 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 09.05.2019 llogaria është debituar në shumën 3 500 euro me përshkrimin “-transferitë me urdhërues shtetasin Andis Neli dhe përfitues shtetasi Julian Kastriot Guri me përshkrimin pagesë qera mujore-“.
- Më datë 10.05.2019 llogaria është debituar në shumën 3 500 euro me përshkrimin “-transferitë me këmbim valutor nga euro në lekë-“.
- Më datë 13.05.2019 llogaria është debituar në shumën 2 000 euro me përshkrimin “-transferitë me urdhërues shtetasin Andis Neli dhe përfitues shtetasi Ismail Bajram Varoshi me përshkrimin pagesë qera mujore-“.
- Më datë 13.05.2019 llogaria është debituar në shumën 3 500 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 15.05.2019 llogaria është debituar në shumën 5 000 euro me përshkrimin “-transferitë për kalim për shoqërinë “BIBA X” shpk – likuidim pjesor fature-“.
- Më datë 20.05.2019 llogaria është debituar në shumën 3 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 20.05.2019 llogaria është debituar në shumën 3 839 euro me përshkrimin “-transferitë për kalim për shoqërinë “MUCA” shpk – likuidim fature-“.
- Më datë 09.07.2019 llogaria është debituar në shumën 8 012 euro me përshkrimin “-transferitë për kalim në llogari të shoqërisë “2N SHEHU PETROL shpk –likuidim fature-“.
- Më datë 09.07.2019 llogaria është debituar në shumën 3 500 euro me përshkrimin “-transferitë me urdhërues shtetasin Andis Neli dhe përfitues shtetasi Julian Kastriot Guri me përshkrimin pagesë qera mujore-“.
- Më datë 30.07.2019 llogaria është debituar në shumën 1 100 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.



- Më datë 01.08.2019 llogaria është debituar në shumën 1 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 05.08.2019 llogaria është debituar në shumën 2 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 14.08.2019 llogaria është debituar në shumën 2 000 euro me përshkrimin “-transfer të me këmbim valutor nga euro në lek-“.
- Më datë 10.09.2019 llogaria është debituar në shumën 2 200 euro me përshkrimin “-transfer të me këmbim valutor nga euro në lek-“.
- Më datë 25.09.2019 llogaria është debituar në shumën 16 000 euro me përshkrimin “-transfer të me këmbim valutor nga euro në lek-“.
- Më datë 25.11.2019 llogaria është debituar në shumën 1 000 euro me përshkrimin “-transfer të për kalim në llogari të shoqërisë “KASTRATI” shpk –likuidim pjesor fature-“.
- Më datë 13.12.2019 llogaria është debituar në shumën 3 230 euro me përshkrimin “-transfer të për kalim në llogari të shoqërisë “KASTRATI” shpk –likuidim përfundimtar fature-“.
- Më datë 13.12.2019 llogaria është debituar në shumën 8 190 euro me përshkrimin “-transfer të për kalim në llogari të shoqërisë “EROIL” sha –likuidim pjesor fature-“.
- Më datë 13.12.2019 llogaria është debituar në shumën 6 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 09.01.2020 llogaria është debituar në shumën 18 000 euro me përshkrimin “-transfer të me këmbim valutor nga euro në lekë-“.
- Më datë 09.01.2020 llogaria është debituar në shumën 4 500 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Taraj (Neli)-“.
- Më datë 15.01.2020 llogaria është debituar në shumën 1 500 euro me përshkrimin “-transfer të me këmbim valutor nga euro në lekë-“.
- Më datë 15.01.2020 llogaria është debituar në shumën 2 500 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 16.01.2020 llogaria është debituar në shumën 3 600 euro me përshkrimin “-transfer të me këmbim valutor nga euro në lekë-“.
- Më datë 10.12.2020 llogaria është debituar në shumën 4 500 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 31.03.2020 llogaria është debituar në shumën 12 000 euro me përshkrimin “-transfer të me këmbim valutor nga euro në lekë-“.
- Më datë 01.04.2020 llogaria është debituar në shumën 3 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 01.04.2020 llogaria është debituar në shumën 1 000 euro me përshkrimin “-transfer të me këmbim valutor nga euro në lekë-“.

- Më datë 06.04.2020 llogaria është debituar në shumën 3 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 14.04.2020 llogaria është debituar në shumën 5 000 euro me përshkrimin “-transfertë për kalim në llogari të shoqërisë “MINING RESOURCES WORLDWIDE-“
- Më datë 04.05.2020 llogaria është debituar në shumën 5 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 08.05.2020 llogaria është debituar në shumën 12 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 08.05.2020 llogaria është debituar në shumën 24 000 euro me përshkrimin “-transfertë me këmbim valutor nga euro në lek-“.
- Më datë 11.05.2020 llogaria është debituar në shumën 13 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 13.05.2020 llogaria është debituar në shumën 1 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 15.05.2020 llogaria është debituar në shumën 1 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 18.05.2020 llogaria është debituar në shumën 2 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 26.05.2020 llogaria është debituar në shumën 2 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 05.06.2020 llogaria është debituar në shumën 3 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 11.06.2020 llogaria është debituar në shumën 13 000 euro me përshkrimin “-transfertë me këmbim valutor nga euro në lekë-“.
- Më datë 11.06.2020 llogaria është debituar në shumën 10 000 euro me përshkrimin “-transfertë me këmbim valutor nga euro në lekë-“.
- Më datë 15.06.2020 llogaria është debituar në shumën 5 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 16.06.2020 llogaria është debituar në shumën 6 000 euro me përshkrimin “-transfertë me këmbim valutor nga euro në lekë-“.
- Më datë 17.06.2020 llogaria është debituar në shumën 3 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 23.06.2020 llogaria është debituar në shumën 2 000 euro me përshkrimin “-transfertë me këmbim valutor nga euro në lekë-“.
- Më datë 24.06.2020 llogaria është debituar në shumën 2 500 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
- Më datë 26.06.2020 llogaria është debituar në shumën 1 000 euro me përshkrimin “-transfertë me këmbim valutor nga euro në lekë-“.



- Më datë 30.06.2020 llogaria është debituar në shumën 10 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
 - Më datë 30.06.2020 llogaria është debituar në shumën 10 000 euro me përshkrimin “-transfertë për kalim në llogari të shoqërisë “MINING RESOURCES WORLDWIDE-”
 - Më datë 01.07.2020 llogaria është debituar në shumën 1 350 euro me përshkrimin “-transfertë për kalim në llogari të shoqërisë “KERRI shpk –likuidim fature-”
 - Më datë 06.07.2020 llogaria është debituar në shumën 2 500 euro me përshkrimin “-transfertë për kalim në llogari të shoqërisë “EUROBETON 2005 shpk –likuidim fature-”
 - Më datë 08.07.2020 llogaria është debituar në shumën 1 075 euro me përshkrimin “-transfertë për kalim në llogari të shoqërisë “EUROBETON 2005 shpk –likuidim fature-”
 - Më datë 10.07.2020 llogaria është debituar në shumën 5 000 euro me përshkrimin “-transfertë për kalim në llogari të shoqërisë “G O TRADING sha –likuidim fature”
 - Më datë 10.07.2020 llogaria është debituar në shumën 3 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
 - Më datë 10.07.2020 llogaria është debituar në shumën 2 000 euro me përshkrimin “-transfertë me këmbim valutor nga euro në lek-“.
 - Më datë 15.07.2020 llogaria është debituar në shumën 2 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
 - Më datë 20.07.2020 llogaria është debituar në shumën 5 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
 - Më datë 24.07.2020 llogaria është debituar në shumën 3 500 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
 - Më datë 29.07.2020 llogaria është debituar në shumën 5 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
 - Më datë 19.08.2020 llogaria është debituar në shumën 3 500 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
 - Më datë 01.09.2020 llogaria është debituar në shumën 3 000 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
 - Më datë 04.09.2020 llogaria është debituar në shumën 1 500 euro me përshkrimin “-tërheqje cash nga Andis Neli-“.
 - Më datë 15.12.2020 llogaria është debituar në shumën 1 000 euro me përshkrimin “-transfertë me këmbim valutor nga euro në lekë-“.
- Llogari Nr.503003237, në monedhën lek, çelur më datë 06.09.2017 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 23 037 252 lekë dhe debituar në shumën 23 009 924 lekë. Balanca më datë 09.03.2021 është 27 328 lekë. Llogaria është kredituar me derdhje cash nga vetë shtetasi Andis Neli, këmbim valutor nga euro në lek dhe debituar,

paga mujore, dieta, pagesa për kontribute sigurimesh shëndetësore dhe shoqërore, tërheqje cash, pagesë për të tretë, pagesë për tatime, komisione banke.

Banka "Credins" sha. Me shkresën Nr.9258/1 Prot, datë 05.03.2021 Banka "Credins", informon se kanë llogari bankare pranë kësaj banke shtetasit dhe shoqëritë e mëposhtme:

Ramazan Omer Keskin:

- Llogari Nr.00001029182, në monedhën euro, çelur më datë 18.04.2018. Llogaria është kredituar në shumën 5 euro në momentin e çeljes. Në këtë llogari nuk është kryer asnjë veprim. *Llogari pa interes.*
- Llogari Nr.00001053684, në monedhën lek, çelur më datë 18.04.2018 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 6 203 lekë dhe debituar në shumën 3 615 lekë. Balanca më datë 01.03.2021 është 2 588 lekë. *Llogari pa interes.*
- Llogari Nr.00001053689, në monedhën euro, çelur më datë 18.04.2018 dhe aktualisht aktive. Në këtë llogari nuk është kryer asnjë veprim. *Llogari pa interes.*

Andis Ramazan Neli:

- Llogari Nr.00001027304, në monedh lek, çelur më datë 06.02.2018 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 1 300 350 lekë dhe debituar në shumën 1 299 038 lekë. Balanca më datë 01.03.2021 është 1312 lekë. Llogaria është kredituar me derdhje cash nga shtetasi Andis Neli, nga shoqëria "REALIZ" shpk me përshkrimin "-kreditim page-" dhe debituar me tërheqje nga vetë ky shtetas dhe pagesa për të tretë, pagesë për kontribute shoqërore dhe shëndetësore.
- Llogari karte Nr.00001027431, në monedhë lekë, çelur më datë 28.02.2018 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 10 972 lekë me përshkrimin "-xhirim llogarie dhe mbushje llogarie Visa klas-" dhe debituar me blerje me kartë dhe komision banke.
- Llogari karte Nr.00001028924, në monedh euro, çelur më datë 03.04.2018 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 1 000 euro me përshkrimin "-xhirim llogarie dhe mbushje llogarie Visa klas-" dhe debituar me blerje me kartë dhe komision banke në shumën 529 euro. Balanca në llogari më datë 01.03.2021 është 471 euro.
- Llogari Nr.00001063517, në monedhë euro, çelur më datë 15.05.2018 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 95 840 euro dhe debituar në shumën 95 325 euro. Balanca më datë 01.03.2021 është 515 euro. Llogaria është kredituar me derdhje cash nga shtetasi Andis Neli, nga shoqëria "REALIZ" shpk dhe disburim kredie në shumën 83 000 euro. Debituar me "-Urdhër xhirimi në favor të Perian Bodinaku PF (notere) kalim sipas kontratës Nr.rep/kol 1061/533, datë 05.02.2020-".
- Llogari Nr.00001373631, në monedhë paund, çelur më datë 14.05.2020 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 37 291 paund dhe debituar në shumën 37 249 paund. Balanca më datë 01.03.2021 është 41 paund. Llogaria është kredituar me shtatë transferta nga bankat e tjera me urdhërues shtetasit Roland Dika, Agim Bresa, Elisa Barçi. Llogaria është debituar me tërheqje cash nga shtetasi Andis Neli dhe në favor të sghoqërisë "REALIZ" shpk.

- Llogari Nr.00001027294 në monedhë euro, çelur më datë 06.02.2018 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 2 000 euro dhe debituar në të njëjtën shumën. Balanca më datë 01.03.2021 është zero euro. Llogaria është kredituar me një derdhje cash nga shtetasi Andis Neli. Debituar me një transfertë me përshkrimin “-pagesë për këtë kredie-“.
- Llogari karte Nr.00001047143 në monedhë euro, çelur më datë 30.03.2018 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 1 000 euro dhe debituar në të njëjtën shumën. Balanca më datë 01.03.2021 është zero euro. Llogaria është kredituar me një derdhje cash nga shtetasi Andis Neli. Debituar me një transfertë me përshkrimin “-mbushje karte-“.

Shoqëria “GLOBAL LEADER IN SPORT” shpk:

- Llogari Nr.00001289244, në monedhën lekë, çelur më datë 31.10.2019. Llogaria është kredituar në shumën 13 411 lekë dhe debituar në shumën 10 395 lekë. Balanca më datë 01.03.2021 është 3 015 lekë. *Llogari pa interes.*
- Llogari Nr.00001289246, në monedhën euro, çelur më datë 31.10.2019 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 486 euro dhe debituar në të njëjtën shumën. Llogaria është kredituar me një derdhje cash nga shtetësja Ermelinda Roshi dhe debituar me një pagesë për shoqërinë “PLAZA TIRANË” sha.

Shoqëria “REALIZ” shpk:

- Llogari Nr.00001052514, në monedhën lekë, çelur më datë 13.04.2018. Llogaria është kredituar në shumën 18 872 806 lekë dhe debituar në shumën 18 847 838 lekë. Balanca më datë 01.03.2021 është 24 968 lekë. Llogaria është kredituar me derdhje cash nga shtetasi Andis Neli, me xhirim nga shoqëria “REALIZ” shpk, derdhje nga të tretë, nga shoqëria “REALIZ” shpk me përshkrimin “-këmbim valutë-“. Llogaria është debituar me tërheqje cash, pagesë për të tretë, pagesë për kontribute shëndetësore dhe shoqërore, komision banke.
- Llogari Nr.00001052515, në monedhën euro, çelur më datë 13.04.2018 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 375.295 euro dhe debituar në shumën 375 242 euro. Balanca më datë 01.03.2021 është 52 euro. Llogaria është kredituar me derdhje cash nga shtetasi Ramazan Keskin në total në shumën 176 000 euro, disbursim kredie në shumën 48 000 euro, derdhje nga shtetasi Andis Neli. Llogaria është debituar me veprime si, kalim në depozitë pa afat, tërheqje nga llogaria nga Andis Neli, kalim në llogari për të tretë, pagesë për shlyerje kredie.
- Llogari Nr.00001052516 në monedhën dollarë, çelur më datë 13.04.2018 dhe mbyllur më datë 22.05.2019. Llogaria është kredituar në shumën 26 dollarë. Llogari pa interes.
- Llogari Nr.00001058149, në monedhën lekë, çelur më datë 30.04.2018 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 660 000 lekë dhe debituar në të njëjtën shumën. Balanca më datë 01.03.2021 është zero lekë. Llogaria është kredituar me derdhje cash nga shoqëria me përshkrimin “-garanci bankare për shoqërinë-“. Llogaria është debituar me përshkrimin “-kalim në llogari të shoqërisë-“.

- Llogari Nr.00001063801, në monedhën lekë, çelur më datë 31.05.2018 dhe mbyllur më datë 23.05.2019. Llogaria është kredituar në shumën 6 533 lekë dhe debituar në të njëjtën shumë. Balanca më datë 01.03.2021 është zero lekë. *Llogari pa interes.*
- Llogari Nr.00001063808, në monedhën euro, çelur më datë 31.05.2018 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 2 583 euro dhe debituar në të njëjtën shumë. Balanca më datë 01.03.2021 është zero euro. Llogaria është kredituar me një urdhër xhirimi për mbushje karted he debituar me blerje me kartë jashtë vendit.
- Llogari Nr.00001457086, në monedhën paund, çelur më datë 31.12.2020 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 30 paund. *Llogari pa interes.*
- Llogari Nr.00001057943, në monedhën euro, çelur më datë 30.04.2018 dhe aktualisht aktive. Llogaria është kredituar në shumën 150 435 euro dhe debituar në shumën 149 638 euro. Balanca më datë 01.03.2021 është 796 euro. Llogaria është kredituar me një kalim nga një llogari tjetër e shoqërisë "REALIZ" shpk për depozitë pa afat. Llogaria është debituar me xhirim për kalim në një llogari tjetër, mbyllje kredie, tërheqje cash nga shtetasi Andis Neli.

Banka "ProCredit" sha, Banka "Amerikane e Investimeve" (ABI), Banka "OTP", Banka "First Investment Bank" (FiBank), Banka "Tirana", Banka "Bashkuar e Shqipërisë", (UBA), Banka "Alpha", Banka "IntesaSanPaolo", Banka "Union" me shkresat përkatëse kanë informuar se shtetasit dhe shoqëritë e kërkuara, rezulton se nuk kanë llogari pranë këtyre bankave.

Nga ana e organit të akuzës është kërkuar informacion edhe nga shoqëria e transfertave Western Union (Unioni Financiar). Me shkresën Nr.1228 Prot, datë 13.07.2021 Western Union (Unioni Financiar), informon se, janë kryer transaksione pranë kësaj shoqëria nga këta shtetas :

- Më datë 31.08.2019 shtetësja Laura Kokëdhima ka dërguar nga Shqipëria shumën 975 euro me përfitues shtetasin Andis Neli.
- Më datë 03.06.2020 shtetasi Andis Neli ka dërguar nga turqia drejt shtetasit Hayale Sokmen shumën 373 euro.
- Më datë 15.06.2020 shtetasi Andis Neli ka dërguar nga turqia drejt shtetasit Mert San Odabasi shumën 474 euro.
- Më datë 14.04.2021 shtetasi Andis Neli ka dërguar nga turqia drejt shtetasit Sevda Senturk shumën 474 euro.

Nga ana e organit të akuzës është kërkuar informacion edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor. Me shkresën nr.3739/1 Prot, datë 01.03.2021 DPSHTRR informon se ka automjete të regjistruara pranë këtij institucioni vetëm shtetasi : Andis Nazmi Neli: automjeti i llojit autoveturë, marka Mercedes Benz, tipi 222, modeli 350 Bluetec, ngjyra e bardhë, me targa AA777LH, viti i prodhimit 2014, shasi Nr.WDD2221321A057277. Këtë automjet ky shtetas e ka blerë në bazë të kontratës së shit-blerjes së pasurisë së luajtshme Nr.rep/kol 1982/1279/2, datë 19.012.2020, me palë shitëse shtetasin Gjelosh Mark Prendi, kontratë e nënshkruar para noter Flora Mëhilli. Çmimi i blerjes 9 000 euro.

Nga ana e organit të akuzës është kërkuar informacion edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Me shkresën Nr.3652/1 Prot, datë 05.03.2021, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informon se:

- Më datë 07.11.2014 shtetasi Altin Neli alias Andis Neli (*kompani eksportuese nga vendi i orgjinës*) ka zhdoganuar në Degën Doganore, Tiranë me deklaratë doganore Nr.75257, artikullin e llojit autoveturë, identiteti i mjetit DK02KZN, me vend të orgjinës Britani e Madhe, me kompani importuese “Andis Neli, Burrel, Mat”, shasi Nr. WWVZZZ3BZ2P342531, me vlerë të deklaruar të faturës 150 000 lekë. Ky mjet është futur nga Pika e kalimit të Kufirit, Murriqan.
- Më datë 22.03.2014, Fatlum Musliu (*kompani eksportuese nga vendi i orgjinës*) ka eksportuar nga Austria me shoqëri importuese “Andis Neli, Burrel, Mat”, e cila ka zhdoganuar në Degën Doganore, Durrës me deklaratë doganore Nr.20993, artikullin e llojit autoveturë, identiteti i mjetit LI-275BZ 21.03.2014, me vend të orgjinës Austri, me kompani importuese “Andis Neli, Burrel, Mat”, shasi Nr. WAUZZZ4E47N010161, me vlerë të deklaruar të faturës 5 000 euro. Ky mjet është futur nga Pika e kalimit të Kufirit, Morinë.
- Më datë 01.07.2015, Isabelle Nocilla (*kompani eksportuese nga vendi i orgjinës*) ka eksportuar nga Franca me shoqëri importuese “Andis Neli, Burrel, Mat”, e cila ka zhdoganuar në Degën Doganore, Durrës me deklaratë doganore Nr.53839, artikullin e llojit autoveturë, identiteti i mjetit AW615KQ MARINA 01.07.2015, me vend të orgjinës Francë, me kompani importuese “Andis Neli, Burrel, Mat”, shasi Nr. WDD1690071J067171, me vlerë të deklaruar të faturës 850 euro. Ky mjet është futur nga Pika e kalimit të Kufirit, Durrës.
- Më datë 25.09.2017, kompania eksportuese nga vendi i orgjinës SERVEX GLOBAL ka eksportuar nga Turqia me shoqëri importuese “Ramazan Keskin”, e cila ka zhdoganuar në Degën Doganore, Tiranë me deklaratë doganore Nr. 86103, artikullin e llojit shisha (nargjile), me vend të orgjinës Turqi, me vlerë të deklaruar të faturës 342 euro. Ky mjet është futur nga Pika e kalimit të Kufirit, Rinas.

Shoqëria “REALIZ” shpk, me Nr. NIPTI L71822022A. Kjo shoqëri ka kryer veprime doganore në degët doganore, Tiranë, Rinas, Kapshticë për periudhën Shtator 2018-Nëntor 2020, në 64 raste për artikuj në funksion të objektit të aktivitetit të shoqërisë “REALIZ” sh.p.k (artikuj për gurore). Në total kjo shoqëri ka deklaruar në doganë blerjen e mallrave me vlerë në shumën totale: 3115 euro, 200 dollarë, 2 400 lira turke dhe 200 paund. Për shtetasin Ramazan Keskin më datë 02.12.2020 është lëshuar një urdhër arresti evropian për veprën penale të “*trafikimit ndërkombëtar të lëndëve narkotike*” në kuadër të organizatës kriminale.

Duke mbajtur parasysh sa më sipër, organi i akuzës ka arritur në përfundimin se shtetasi Ramazan Keskin dhe personat e lidhur me të janë subjekt i masave parandaluese kundër pasurisë në zbatim gërmave “a” dhe “c” të pikës 1, gërmës “a” të pikës 2 të nenit 3, të Ligjit Nr. 10192,

datë 03.12.2009 "Për Parandalimin dhe goditjen e Krimit të Organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" të ndryshuar.

Ndër të tjera në kërkesën penale objekt shqyrtimi organi i akuzës ka arsyetuar se : "... Pasuritë e përshkruara më sipër të shtetasit Ramazan Keskin dhe familjarëve të tij, dyshohet se janë vendosur nga të ardhurat e krijuara nga aktiviteti kriminal dhe bazuar në nenin 11 të ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 "Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit dhe Korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" duhet të vendoset sekuestro mbi këto pasuri. Së pari, pasuritë e mësipërme janë pasuri që plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 11 i ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm se shtetasi Ramazan Keskin është i përfshirë në veprimtarinë kriminale të veprës penale "Trafikimit të narkotikëve" dhe " Grupi i strukturuar kriminal" dhe "Organizata kriminale" sipas legjislacionit penal Gjerman, parashikuar njëkohësisht si veprë penale nga nenet 283/a dhe 333/a, 334 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, si dhe pasuritë në fjalë janë krijuar gjatë përshirjes së këtij shtetasi në veprimtarinë kriminale të mësipërme. Së dyti, pasuria e mësipërme, zotërohet nga shtetasit e sipërpërmendur si subjekt të ligjit dhe ekzistojnë prova konkrete se janë të pajustificuara. Duke u krahasuar vlera e tyre me të ardhurat e fituara në rrugë të ligjshme, rezulton se vlera e tyre nuk iu përgjigjet dukshëm nivelit të të ardhurave dhe të fitimeve të realizuara në rrugë të ligjshme. Së treti, ka arsye të bazuara për të besuar në lidhur me pasurinë e mësipërme ekziston rreziku real për humbjen, për marrjen apo për transferimin e saj tek persona të tjerë, me qëllim për të bërë të pamundur konfiskimin e këtyre pasurive. ...".

II. LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM.

Ligji Nr. 10192 dt. 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" i ndryshuar (në vijim Ligji) :

Neni 3 me titull "Fusha e zbatimit" përcakton : " 1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, siç përcaktohet në pikën 2, të këtij neni, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, për :

- a) pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga banda e armatosur, organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal;
- b) pjesëmarrje dhe kryerje e krimeve nga organizata terroriste dhe krimeve për qëllime terroriste, parashikuar nga kreu VII i Kodit Penal;
- c) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal;
- ç) pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal;

d) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 164/a, 164/b, 183, 244, 244/a, 245, 245/1, 256, 257, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e të Kodit Penal, në rastet kur ekzistojnë indicie për përfitim pasuror të paligjshëm.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga :

a) personat e afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta;

b) personat fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre.

3. Prezumi i regjistrimit të rremë të pasurive dhe veprimtarive ekonomike të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në emër të personave të afërm, të përmendur në shkronjën "a", të pikës 2, të këtij neni, zbatohet kur ka të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmërinë e origjinës së pasurisë.

4. Të dhënat e mjaftueshme që pasuritë ose veprimtaritë e personit fizik ose juridik të përmendur në shkronjën "b", të pikës 2, të këtij neni, zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë, nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, nxirren nga marrëdhënia ndërmjet personit fizik dhe juridik me personat e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, dhe nga të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmërinë e origjinës së pasurisë.

5. Masat parandaluese mund të kërkohen dhe ndaj trashëgimtarëve të personit, subjekt i zbatimit të këtij ligji, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 vjet nga data e vdekjes. 6. Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të vëna përpara hyrjes në fuqi të tij, me kusht që të ekzistojnë indicie të rëndësishme për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale, në kohën e vënies së pasurisë."

Neni 7 pika 1 dhe 4 me titull "Kompetenca dhe përbërja e gjykatës" përcakton : "1. Kërkesa për marrjen e masave parandaluese, sipas këtij ligji, shqyrtohet në shkallë të parë, nga gjykatat e rretheve gjyqësore ose gjykata e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në bazë të kompetencës përkatëse lëndore për veprën penale të kryer, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale. (...). 4. Kërkesa për marrjen e masave parandaluese, sipas këtij ligji, shqyrtohet në shkallë të parë me një gjyqtar. Ankimi kundër vendimit për marrjen e masës parandaluese shqyrtohet nga gjykatat e apelit ose Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë."

Neni 11 me titull "Kriteret për sekuestrimin e pasurisë" përcakton : "1. Me kërkesë të arsyetuar të prokurorit, gjykata vendos sekuestrimin e pasurive, të zotëruara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në pronësi të plotë ose të pjesshme të personave, sipas nenit 3, pika 1, të këtij ligji, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, që tregojnë se personi është përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura shpërpjesëtimore në raport me nivelin e të ardhurave apo fitimeve nga veprimtari të ligjshme të deklaruara dhe që nuk përlligjen prej tyre, si dhe kur :

a) ekziston një rrezik real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji; ose

b) ka dyshime të arsyeshme që tregojnë se zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive të caktuara ekonomike, tregtare dhe profesionale janë në gjendje rreziku apo ndikimi nga ana e një organizate kriminale ose që mund të lehtësojnë veprimtaritë kriminale. ...”.

Neni 12 me titull “Procedura e sekuestrimit” përcakton : “ 1. Kërkesa për sekuestrimin e pasurisë shqyrtohet nga gjykata në dhomën e këshillimit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes, në bazë të dokumenteve dhe akteve të paraqitura nga prokurori. 2. Vendimi për masën e sekuestrimit është i ekzekutueshëm me shpalljen e tij. Masa e sekuestrimit është e vlefshme për një periudhë gjashtëmujore, duke filluar nga momenti i zbatimit të saj. ...”

III. VLERËSIMI I GJYKATËS.

Nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nëpërmjet kërkesës së paraqitur është kërkuar : “Sekuestrim i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në zotërimin të shtetasit Ramazan Keskin, i datëlindjes 01.01.1979, lindur në Turqi dhe banues në Shqipëri”. Sipas organit të akuzës pasuritë e shtetasit Ramazan Keskin dhe familjarëve të tij nuk justifikohen me të ardhura të ligjshme. Duke qënë subjekte të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar, është konstatuar se nga këta shtetas janë krijuar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të cilat nuk justifikohen me të ardhurat e ligjshme. Dyshohet se pasuritë objekt sekuestrimi janë produkt i aktivitetit të kundraligjshëm në fushën e “Trafikimit të narkotikëve” në bashkëpunim të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal.

Për të vendosur në lidhje me kërkesën e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Gjykata i referohet parashikimeve të Ligjit Nr. 10192 dt. 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar.

Në analizë të provave shkresore të administruara nga ana e gjykatës (të cilat i janë bashkëlidhur kërkesës) si dhe shpejgimeve të dhëna në kërkesën penale objekt gjykimi, çmohet se kërkesa duhet pranuar si e bazuar në ligj dhe në prova. Gjykata arrin në këtë përfundim duke analizuar si më poshtë :

Së pari, organi i akuzës kërkon që në kuadër të Ligjit Nr. 10192 dt. 03.12.2009 i ndryshuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të caktojë masa parandaluese me karakter pasuror si ajo e sekuestrimit të pasurive që janë në pronësi të shtetasit Ramazan Keskin dhe të familjarëve të tij (Juna Harka – bashkëshortja). Më konkretisht kërkohet që të sekuestrohen pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme si më poshtë :

1. *Pasurina Nr. 157/13, ZK.3292, Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-100-(26-B), me adresë, Selitë, Tiranë, me sipërfaqe 1000 m2, e llojit "ullishte".*
2. *Automjeti tip Audi SQ7, me targa gjermane LR-II7777, me nr. shasie Nr. WAUZZZ4M5HD052188.*
3. *Automjeti autoveturë, marka AUDI, tipi Q7, targa AA275SB, me shasi Nr. WUAZZZ4L3BD026080, viti i prodhimit 2011.*
4. *25% të aksioneve të Operatorit Ekonomik "GLOBAL LEADER IN SPORT (GLS)" shpk- Nr. NIPT L92229020F, regjistruar më datë 29.10.2019, datë themelimi 28.10.2019, me adresë Business Center Sun Tower, Rruga e "Kavajës, Tiranë, me objekt veprimtarie "Organizimi i eventeve sportive duke përfshirë: Vendosja ose ngritja e skenave për eventet e futbollit; Rekrutime të personelit në lidhje me ndeshjet që do të zhvillohen kudo; Blerje të veshjeve sportive; Blerja e biletave të avionit; Rezervimi i hoteleve. Shitja e biletave të futbollit etj. Shoqëria do të ketë si objekt organizimin e eventeve të futboollit në Shqipëri dhe mbarë botën në rang ndërkombëtar si : Ftesën për pjesëmarrjen e legjendave të futbollit në evente sportive të organizuar nga vetë shoqëria etj .- ". Në këtë operator ekonomik administrator është shtetasi Andis Neli, i cili është edhe ortak me 25% të aksioneve, ndërsa shtetasi italian Massimiliano Suglia është ortak me 50% të aksioneve.*
5. *50% të aksioneve të Operatorit Ekonomik "KESKINDAG" shpk- Nr. NIPT L71726012K, regjistruar më datë 26.05.2017, datë themelimi 24.05.2017, me adresë Njësia Administrative Nr.10, Rruga "Kajo Karafili", Vila 2-katëshe Nr.18, Tiranë, me objekt veprimtarie "Restorant, Bar, Kafë. Shërbime të cateringut. Të hapë restorante, ti manaxhoje ato, ti japë me qira. Tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve industrial, ushqimor, bujqësor, detar, ndërtim etj. Prodhim dhe tregtim me shumicë e pakicë të artikujve tregtar, konfeksione, tekstil për llogari të vet dhe për të tretë. Ndërtim civil, industrial, infrastrukturë. Shit-blerje me pakicë dhe shumicë të çdo artikulli tregtar që mund të tregtohet brenda legjislacionit Shqiptar. Import eksport. Shit-blerje mjetesh motorrike apo makineri të ndryshme për transport personal dhe publik. Marrja pjesë nëpër ankande dhe tendera, si dhe të bëjë shërbime që kanë lidhje me objektin e veprimtarisë së saj. Blerje pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, t'i marrë ose t'i lëshojë me qera, të marrë tenderin e tyre. Shoqëria, mund të kryejë për përmbushjen e qëllimeve të saj çdo lloj operacioni tregtar, mund të vendosë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, t'a hipotekojë këtë pasuri në rregjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të saj. Mund të hyjë në tratativa dhe biznese me shoqëri të tjera që kanë të njëjtin objekt veprimtarie për të realizuar fitime në fushat e përmendura në këtë nen. Përfitojë, transferojë, të marrë apo japë me qera, të blejë dhe shesë, si dhe të kontrakttojë, të drejtën e markës, patentes, licencës, dhe të drejtat e tjera që janë të ngjashme me këto. Shoqëria, siç mund të ushtrojë punët që tregohen në objektin e veprimtarisë së saj, brenda dhe jashtë vendit, ashtu edhe mund të marrë pjesë, të përfitojë apo të, transferojë nga/te palët e tjera, mund të marrë pjesë në kapitalin e personave juridike dhe fizikë, të vëndit apo të huaj, të krijuar ose që krijohen me qëllim tregtie, industrie, etj., në lidhje me këto fusha - ". Në këtë operator ekonomik*

administratorë janë shtetasit Mustafa Dag dhe Mehmet Dag. Këta dy shtetas janë edhe ortakë të shoqërisë me nga 25% të aksioneve secili.

6. 50% të aksioneve të Operatori Ekonomik "REALIZ" shpk - Nr.NIPT L71822022A, regjistruar më datë 22.06.2017, datë themelimi 05.06.2017, me adresë, Rruga "Tre Dëshmorët", Pallati Ink, Kati I, Yzberish, Kashar, Tiranë, me objekt veprimtarie "shfrytëzim të mineraleve të grupit të ndërtimit dhe metalor. Ushtrimi i aktivitetit të shfrytëzimit mineral për mineralin Traktolit, import - eksport; Shfrytëzim i burimeve natyrore të tokës dhe nëntokës të burimeve natyrore, gjeometrike etj. Import eksport i materialeve tekstile, konfeksione, makineri e pajisje qepëse të tekstileve, përpunim, konfeksionim e qepje e tregtim me shumicë e pakicë i konfeksioneve. Transaksione financiare nga Shqipëria për jashtë dhe nga jashtë për në Shqipëri. Të merret me promovimin e shkëmbimeve tregtare nga Shqipëria për jashtë dhe nga jashtë për në Shqipëri. Të merret me terhoqjen e investimeve dhe investitorëve të huaj në Shqipëri. Të merret me ofrimin e shërbimeve këshillimore për investitorët e huaj. Të merret me studimin dhe prezantimin e mundësive të mira për biznes dhe aktivitete investuese në Shqipëri. Të merret me ofrimin e ndihmave teknike dhe ligjore për kompanitë e huaja që duan të merren e investojnë në Shqipëri veçanërisht në fushën e infrastrukturës (konfeksione të të gjitha llojeve, ndërtim, energji, burimet ujore, etj). Hapje agjensi imobiliare. Hapje agjensi punësimi dhe ndërmjetësimi. Hapje agjensi reklamash dhe publicitare. Zgjidhje, shërbime, konsulence, trajnime në fushën e informacionit. Importim dhe eksportim si dhe tregëtim me shumicë dhe pakicë e artikujve të ndryshëm industrial e ushqimor, pjesë këmbimi. Ndërtime civile – industrial - turistike- bujqësore, rikonstruksione. Ndërtim banese me skelet mbi 8 kate. Ndërtime rrugore. Ndërtim rruge kategoria IV dhe V. Ndërtim rruge kategoria III dhe II. Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndërtim mbi shtresa rrugore. Ndërtim autostrade, pista, aeroporte, heliporte. Ndërtime hidraulike e Hidroteknike. Ndërtimi ujesjellës – kanalizime - kanale dhe impiante vaditëse. Punime mbrojtje të sistemit hidraulik - çimentime etj. Ndërtim impiante të trajnimit të ujit. Ndërtim vajsjellës, gazsjellës, naftësjellës. Ndërtim diga - damba deri në 10 m. Ndërtim galeri - tunele. Ndërtim diga të larta. Vepra të veçanta e punime specifike, sillose, kulla, kulla uji eti - metalike. Përforcime themeli e punime nën tokësore. Izolime mbi dhe nën tokësore nga ujërat. Themele të veçanta. puse, shpime gjeologjike inxhinerike - shpime për ujë. Punime restaurimi, restaurimi i ndërtesave monument kulture. Punime restaurimi i veprave arkeologjike. Punime karpentiere. Druri. Metali. Impiante teknologjike dhe të veçanta. Instalimi i impianteve ngritëse dhe transportuese ashensore, shkallë lëvizëse, transportues në përgjithësi) - mirembajtja e tyre. Instalimi i impianteve termike ventilimit - kondicionimit të ajrit- mirembajtja e tyre. Instalimi i impianteve higjenike, kuzhina, lavanderi, hidrosanitare, mirembajtja e tyre. Punime shërbimi. Punime me sipërfaqe të gjelbërta parqe - pyll parqe. Pastrimi i sipërfaqeve urbane. Kryerja e punimeve në shërbesa funerale. Mirembajtja dhe zhvillimi i dekorit në mjedise urbane, ndricimi e sinjalizimi urban. Ky aktivitet do të ushtrohet pas marrjes së licences. Importim dhe

eksportim si dhe tregëtim me shumicë dhe pakicë e artikujve të ndryshëm industriale e ushqimore, pjesë këmbimi të paisjeve kompjuterike, elektro- shtëpiake. Tregëtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me shumicë dhe me pakicë artikuj të ndryshëm ushqimore, elektike, kompjuterike, hidrosanitare, hidraulike, prodhime qeramike, konfeksione të ndryshme, prodhime kozmetike dhe estetike të ndryshme, bimë medicinale dhe eterovajore. Tregëtim të lëndës drusore, bojërave të ndryshme plastike për mure e fasada, kimikate e lënde të para për prodhimin e tyre. Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, bare, restorante, diskoteka, qendra pushimi dhe kurative. Punime druri mobilje, orendi prodhime duralumini dhe tregëtimi i tyre. Prodhim materiale të ndryshme ndërtimi si pllaka për shtrim e veshje të objekteve të ndërtimit, banesave, tulla e tjegulla të llojeve të ndryshme. Investime dhe pjesëmarrje në investime duke bashkëpunuar me shoqëri të tjera vendase dhe të huaja në fuzhat e industrisë, bujqësisë, industrise ushqimore transport si dhe ndërtim të objekteve si të banesave shumëkatëshe, ura, kanalizime, dekore të fasadave e rikonstruksione të godinave të llojeve të ndryshme, etj. Aktivitet në fushën e transportit të brëndshëm e të jashtëm për udhëtarë e për mallra në menyre tokesore si dhe servise per te gjitha llojet e automjeteve. Studime, projektme, ndërtime civile hidroteknike dhe hidroenergjitike, prodhim dhe tregëtim te energjise elektrike, ndertim e shfrytëzim te rrjetit hidroenergjitik, linje prodhimi uji të pishëm dhe lengje te tjera e mirembajje te tyre. Aktivitete në fushën e ndërtimit: Germime dheu me punime eventuale murature e beton arme prishje dhe punime ne toke te germuar. Prodhim material ndërtimi. Prodhim material inerte - gure. Prodhime qeramika tulla-tjegulla-fajance. Prodhim elemente betoni e betonarme të zakonshëm pararendur- gure dekorative. Prodhim materiale lidhes gelqere - allci çimento. Prodhim materiale me baze bitiumi sintetike. Ndertime civile dhe ekonomike. Ndertime civile industrial-turistike- bujqësore. Aktivitet në fushën e restaurimit të Monumenteve Historike dhe ato kulturore". Në këtë operator ekonomik administrator është shtetasi Andis Neli, i cili është edhe ortak me 50% të aksioneve.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është subjekt i caktuar nga ligji (neni 7/1 i tij) për të shqyrtuar kërkesën penale objekt gjykimi (për marrjen e masës parandaluese me karakter pasuror – sekuestrimi i pasurisë) pasi shtetasi Ramazan Keskin dyshohet për kryerjen e veprave penale "Trafikimi i narkotikëve" e kryer në bashkëpunim të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal, "Grup i strukturuar kriminal" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale", të parashikuara nga nenet 283/a – 28/4, 333/a dhe 287 të Kodit Penal, (vepra penale të cilat janë në kompetencën lëndore të Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar – sipas nenit 75/a shkronja b) të K.Pr.Penale).

Gjithashtu edhe subjekti procedural që e ka paraqitur kërkesën për caktimin e masës së sekuestros (Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar) është subjekti procedural i cili sipas ligjit të sipërcituar (neni 11/1 i tij) ka të drejtën që të paraqesë këtë kërkesë për shqyrtim para kësaj gjykate.

Së dyti, Gjykata vlerëson se shtetasi Ramazan Keskin është subjekt i këtij ligji (sipas nenit 3/1 gwrma "a") për masat parandaluese me karakter pasuror siç është rasti i sekuestrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të përmendura më lart që rezultojnë se janë në pronësi të tij dhe të familjarëve të tij të parashikuar si të tillë në nenin 3/2 shkronja a) të ligjit. Sipas nenit 3/2 shkronja a) të ligjit rezulton se : "... 2.Dispozitat e këtij zbatohen edhe ndaj pasurive të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga :

a) personat e afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesit), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta; b) personat fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre. ...".

Referuar dokumentacionit të sjellë nga prokuroria rezulton që pasuritë të cilat kërkohet që të sekuestrohen me vendim gjykate janë në pronësi të shtetasit Ramazan Keskin dhe të familjarëve të tij shtetases Juna Harka (bashkëshortja e tij). Pra, referuar nenit 3/2 shkronja a) dhe b) të ligjit, masat parandaluese me karakter pasuror vendosen edhe ndaj pasurive të personave fizikë të cilët janë persona të lidhur me subjektin e hetimit penal. Për pasurinë e cila është në pronësi ose zotërohet nga këto subjekte sipas ligjit, prezumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta.

Së treti, Gjykata vlerëson se mbi bazën e provave shkresore që i janë bashkalidhur kërkesës penale objekt gjykimi disponohen të dhëna të arsyeshme bazuar në element të faktit se shtetasi Ramazan Keskin ka pjesëmarrje në veprimtari kriminale e kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Shtetasi Ramazan Keskin, rezulton që të jenë të shpallur person në kërkim ndërkombëtar në dt. 02.12.2020 (është lëshuar një urdhër arresti evropian, për veprën penale "Trafikimi ndërkombëtar i lëndëve narkotike", e kryer në kuadër të organizatës kriminale). Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka regjistruar procedim penal në ngarkim të shtetasit Ramazan Keskin, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale "Trafikimi i narkotikëve" e kryer në bashkëpunim të veçantë atë të grupit të strukturuar kriminal, "Grup i strukturuar kriminal" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale", të parashikuara nga nenet 283/a – 28/4, 333/a dhe 287 të Kodit Penal.

Së katërti, Gjykata vlerëson se duke mbajtur parasysh sa u arsyetua dhe më sipër ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në indicje se shtetasi Ramazan Keskin, (dhe familjarët e tij) zotërojnë pasuri dhe të ardhura shpërpjestimore në raport me nivelin e të ardhurave apo fitimeve nga veprimtari të ligjshme të deklaruara dhe që nuk përlligjen prej tyre. Duke u krahasuar vlera e tyre me të ardhurat e fituara në rrugë të ligjshme, rezulton se vlera e tyre nuk iu përgjigjet dukshëm nivelit të të ardhurave dhe të fitimeve të realizuara në rrugë të ligjshme. Ndodhur në këto kushte për Gjykatën ekziston rreziku real për humbjen, marrjen apo tjetërsimin e këtyre pasurive mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit sipas dispozitave të ligjit (kështu i parashikuar nga neni 11/1 shkronja b) i ligjit).

Gjykata, mbështetur në arsyetimin e mësipërm vlerëson se masa e sekuestrimit për pasuritë e luajshme dhe të paluajshme të përshkruara më lart në pronësi të shtetasit Ramazan Keskin dhe të familjarëve të tij, e kërkuar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është e ligjshme dhe si e tillë duhet pranuar plotësisht.

Në zbatim të nenit 12/2 të ligjit vendimi për caktimin e masës së sekuestrimit është i ekzekutueshëm më shpalljen e tij dhe masa e sekuestrimit është e vlefshme për një periudhë 6 (gjashtë) mujore duke filluar nga momenti i zbatimit të saj. Pasuritë e sekuestruara do të administrohen nga Agjensia për Administrimin e Paurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Gjykata bazuar në nenin 112 të K.Pr.Penale dhe nenet 3, 7, 10, 11, 12, 14 të Ligjit Nr. 10192 dt. 03.12.2009 "*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*" i ndryshuar

V E N D O S I :

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
2. Vendosjen e masës së sekuestrimit ndaj pasurive të luajshme dhe të paluajshme si mëposhtë:
 - *Pasurina Nr. 157/13, ZK.3292, Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-100-(26-B), me adresë, Selitë, Tiranë, me sipërfaqe 1000 m², e llojit "ullishte".*
 - *Automjeti tip Audi SQ7, me targa gjermane LR-II7777, me nr. shasi Nr. WAUZZZ4M5HD052188.*
 - *Automjeti autoveturë, marka AUDI, tipi Q7, targa AA275SB, me shasi Nr. WUAZZZ4L3BD026080, viti i prodhimit 2011.*
 - *25% të aksioneve të Operatorit Ekonomik "GLOBAL LEADER IN SPORT (GLS)" shpk-Nr. NIPT L92229020F, regjistruar më datë 29.10.2019, datë themelimi 28.10.2019, me adresë Business Center Sun Toëer, Rruga e "Kavajës, Tiranë, me objekt veprimtarie "Organizimi i eventeve sportive duke përfshirë: Vendosja ose ngritja e skenave për eventet e futbollit; Rekrutime të personelit në lidhje me ndeshjet që do të zhvillohen kudo; Blerje të veshjeve sportive; Blerja e biletave të avionit; Rezervimi i hoteleve. Shitja e biletave të futbollit etj. Shoqëria do të ketë si objekt organizimin e eventeve të futbollit në Shqipëri dhe mbarë botën në rang ndërkombëtar si: Ftesën për pjesëmarrjen e legjendave të futbollit në evente sportive të organizuar nga vetë shoqëria etj. - ". Në këtë operator ekonomik administrator është shtetasi Andis Neli, i cili është edhe ortak me 25% të aksioneve, ndërsa shtetasi italian Massimiliano Suglia është ortak me 50% të aksioneve.*

- 50% të aksioneve të Operatorit Ekonomik "KESKINDAG" shpk- Nr. NIPT L71726012K, regjistruar më datë 26.05.2017, datë themelimi 24.05.2017, me adresë Njësia Administrative Nr.10, Rruga "Kajo Karafli", Vila 2-katëshe Nr.18, Tiranë, me objekt veprimtarie "Restorant, Bar, Kafe. Shërbime të cateringut. Të hapë restorante, ti manaxhoje ato, ti japë me qira. Tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve industrial, ushqimor, bujqësor, detar, ndërtim etj. Prodhim dhe tregtim me shumicë e pakicë të artikujve tregtar, konfeksione, tekstil për llogari të vet dhe për të tretë. Ndërtim civil, industrial, infrastrukturë. Shit-blerje me pakicë dhe shumicë të çdo artikulli tregtar që mund të tregtohet brenda legjislacionit Shqiptar. Import eksport. Shit-blerje mjetesesh motorrike apo makineri të ndryshme për transport personal dhe publik. Marrja pjesë nëpër ankande dhe tendera, si dhe të bëjë shërbime që kanë lidhje me objektin e veprimtarisë së saj. Blerje pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, t'i marre ose t'i lëshojë me qera, të marrë tenderin e tyre. Shoqëria, mund të kryejë për përmbushjen e qëllimeve të saj çdo lloj operacioni tregtar, mund të vendosë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, t'a hipotekojë këtë pasuri në rregjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të saj. Mund të hyjë në tratativa dhe biznese me shoqëri të tjera që kanë të njëjtin objekt veprimtarie për të realizuar fitime në fushat e përmendura në këtë nen. Përfitojë, transferojë, të marrë apo japë me qera, të blejë dhe shesë, si dhe të kontrakttojë, të drejtën e markës, patentes, licences, dhe të drejtat e tjera që janë të ngjashme me këto. Shoqëria, siç mund të ushtrojë punët që tregohen në objektin e veprimtarisë së saj, brenda dhe jashtë vendit, ashtu edhe mund të marrë pjesë, të përfitojë apo të, transferojë nga/te palët e tjera, mund të marrë pjesë në kapitalin e personave juridike dhe fizike, të vëndit apo të huaj, të krijuar ose që krijohen me qëllim tregtie, industrie, etj., në lidhje me këto fusha - ". Në këtë operator ekonomik administratorë janë shtetasit Mustafa Dag dhe Mehmet Dag. Këta dy shtetas janë edhe ortakë të shoqërisë me nga 25% të aksioneve secili.
- 50% të aksioneve të Operatori Ekonomik "REALIZ" shpk - Nr.NIPT L71822022A, regjistruar më datë 22.06.2017, datë themelimi 05.06.2017, me adresë, Rruga "Tre Dëshmorët", Pallati Ink, Kati I, Yzberish, Kashar,Tiranë, me objekt veprimtarie "shfrytëzim të mineraleve të grupit të ndërtimit dhe metalor. Ushtrimi i aktivitetit të shfrytëzimit mineral për mineralin Traktolit, import - eksport; Shfrytëzim i burimeve natyrore të tokës dhe nëntokës të burimeve natyrore, gjeometrike etj. Import eksport i materialeve tekstile, konfeksione, makineri e pajisje qepëse të tekstileve, përpunim, konfeksionim e qepje e tregtim me shumicë e pakicë i konfeksioneve. Transaksione financiare nga Shqipëria për jashtë dhe nga jashtë për në Shqipëri. Të merret me promovimin e shkëmbimeve tregtare nga Shqipëria për jashtë dhe nga jashtë për në Shqipëri. Të merret me tërheqjen e investimeve dhe investitorëve të huaj në Shqipëri. Të merret me ofrimin e shërbimeve këshillimore për investitorët e huaj. Të merret me studimin dhe prezantimin e mundësive të mira për biznes dhe aktivitete investuese në Shqipëri. Të merret me ofrimin e ndihmave teknike dhe ligjore për kompanitë e huaja që duan të merren e investojne në Shqipëri veçanërisht në fushën e infrastrukturës

(konfeksione të të gjitha llojeve, ndërtim, energji, burimet ujore, etj). Hapje agjensi imobiliare. Hapje agjensi punësimi dhe ndërmjetësimi. Hapje agjensi reklamash dhe publicitare. Zgjidhje, shërbime, konsulence, trajnime në fushën e informacionit. Importim dhe eksportim si dhe tregëtim me shumicë dhe pakicë e artikujve të ndryshëm industrial e ushqimor, pjesë këmbimi. Ndërtime civile – industrial - turistike- bujqësore, rikonstruksione. Ndërtim banese me skelet mbi 8 kate. Ndërtime rrugore. Ndërtim rruge kategoria IV dhe V. Ndërtim rruge kategoria III dhe II. Punime të mirembajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndërtim mbi shtresa rrugore. Ndërtim autostrade, pista, aeroporte, heliporte. Ndërtime hidraulike e Hidroteknike. Ndërtimi ujesjellës – kanalizime - kanale dhe impiante vaditëse. Punime mbrojtje të sistemit hidraulik - çimentime etj. Ndërtim impiante të trajnimit të ujit. Ndërtim vajsjellës, gazsjellës, naftësjellës. Ndërtim diga - damba deri në 10 m. Ndërtim galeri - tunele. Ndërtim diga të larta. Vepra të veçanta e punime specifike, sillose, kulla, kulla uji eti - metalike. Përforcime themeli e punime nën tokësore. Izolime mbi dhe nën tokësore nga ujërat. Themele të veçanta. puse, shpime gjeologjike inxhinerike - shpime për ujë. Punime restaurimi, restaurimi i ndërtesave monument kulture. Punime restaurimi i veprave arkeologjike. Punime karpentiere. Druri. Metali. Impiante teknologjike dhe të veçanta. Instalimi i impianteve ngritëse dhe transportuese ashensore, shkallë lëvizëse, transportues në përgjithësi) - mirembajtja e tyre. Instalimi i impianteve termike ventilimit - kondicionimit te ajrit- mirembajtja e tyre. Instalimi i impianteve higjenike, kuzhina, lavanderi, hidrosanitare, mirëmbajtja e tyre. Punime shërbimi. Punime me sipërfaqe të gjelbërta parqe - pyll parqe. Pastrimi i sipërfaqeve urbane. Kryerja e punimeve në shërbesa funerale. Mirembajtja dhe zhvillimi i dekorit në mjedise urbane, ndricimi e sinjalizimi urban. Ky aktivitet do të ushtrohet pas marrjes së licences. Importim dhe eksportim si dhe tregëtim me shumicë dhe pakicë e artikujve të ndryshëm industriale e ushqimore, pjesë këmbimi të paisjeve kompjuterike, elektro- shtëpiake. Tregëtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me shumicë dhe me pakice artikuj të ndryshëm ushqimore, elektike, kompjuterike, hidrosanitare, hidraulike, prodhime qeramike, konfeksione të ndryshme, prodhime kozmetike dhe estetike të ndryshme, bime medicinale dhe eterovajore. Tregëtim të lëndës drusore, bojërave të ndryshme plastike për mure e fasada, kimikate e lënde të para për prodhimin e tyre. Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, bare, restorante, diskoteka, qendra pushimi dhe kurative. Punime druri mobilje, orendi prodhime duralumini dhe tregëtimi i tyre. Prodhim materiale të ndryshme ndërtimi si pllaka për shtrim e veshje të objekteve të ndërtimit, banesave, tulla e tjegulla të llojeve të ndryshme. Investime dhe pjesëmarrje në investime duke bashkëpunuar me shoqëri të tjera vendase dhe të huaja në fuzhat e industrisë, bujqësisë, industrisë ushqimore transport si dhe ndërtim të objekteve si të banesave shumëkatëshe, ura, kanalizime, dekore të fasadave e rikonstruksione të godinave të llojeve të ndryshme, etj. Aktivitet në fushën e transportit të brëndshëm e të jashtëm për udhëtarë e për mallra në mënyrë tokësore si dhe servise për të gjitha llojet e automjeteve. Studime, projektme, ndërtime civile hidroteknike dhe hidroenergjitike, prodhim dhe tregëtim të energjisë

elektrike, ndërtim e shfrytëzim të rrjetit hidroenergjitik, linje prodhimi uji të pishëm dhe lëngje të tjera e mirembajtje të tyre. Aktivitete në fushën e ndërtimit: Germime dheu me punime eventuale murature e beton arme prishje dhe punime në toke të germuar. Prodhim material ndërtimi. Prodhim material inerte - gure. Prodhime qeramika tulla-tjegulla-fajance. Prodhim elemente betoni e betonarme të zakonshëm pararendur- gure dekorative. Prodhim materiale lidhës gelqere - allci çimento. Prodhim materiale me baze bitumi sintetike. Ndertime civile dhe ekonomike. Ndertime civileindustrial-turistike-bujqësore. Aktivitet në fushën e restaurimit të Monumenteve Historike dhe ato kulturore". Në këtë operator ekonomik administrator është shtetasi Andis Neli, i cili është edhe ortak me 50% të aksioneve.

3. Ky vendim është i ekzekutueshëm më shpalljen e tij dhe masa e sekuestrimit është e vlefshme për një periudhë 6 (gjashtë) mujore duke filluar nga momenti i zbatimit të saj.
4. Urdhërohet administratori i përzgjedhur pranë Agjensisë për Administrimin e Paurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave për administrimin dhe përdorimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të sekuestruara.
5. Urdhërohet sekretaria e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar që ti dërgojë dy kopje të vendimit prokurorit që ka paraqitur kërkesën z. Vladimir Mara.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, brenda 10 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot më datën 03.02.2023

**GJYQTAR
ERJON CELA**

